REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË LEZHË**



# PËRMBAJTJA E RAPORTIT VJETOR

# TË

# PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË LEZHË

# PËR VITIN 2021

# Tabela e përmbajtjes

**HYRJE** .......... **1**

**I-DREJTIMET DHE PËRPARËSITË NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT PËR VITIN 2021** .......... **3**

1.1-RESPEKTIMI I TË DREJTAVE TË NJERIUT .......... 3

1.2-TË MITURIT DHE GRUPET VULNERABËL, SI TË PANDEHUR DHE VIKTIMA .......... 4

1.3-BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL .......... 6

1.3.1-RAPORTET ME PROKURORINË E PËRGJITHSHME DHE ME KËSHILLIN E LARTË TË PROKURORISË. ZBATIMI I UDHËZIMEVE TË PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM .......... 7

1.3.2-RAPORTET ME STRUKTURAT E POLICISË SË SHTETIT .......... 8

1.3.3-RAPORTET ME GJYKATËN E SHKALLËS SË PARË LEZHË .......... 8

1.3.4-RAPORTET ME PROKURORINË E APELIT SHKODËR .......... 9

1.3.5-RAPORTET ME GJYKATËN E APELIT SHKODËR .......... 9

1.3.6-RAPORTET ME INSTITUCIONET E TJERA VENDORE .......... 9

1.4-BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR .......... 10

1.5-PËRDORIMI I METODAVE SPECIALE TË HETIMIT DHE HETIMET PROAKTIVE .......... 10

1.6-INFORMACION MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE .......... 11

1.7-INFORMACION MBI ZBATIMIN E REZOLUTËS SË KUVENDIT DATË 17.06.2021 “PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË PROKURORISË” .......... 11

1.8-INFORMACION MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE RPIORITARE “PËR LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT PËR VITIN 2021” MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 326, DATË 02.06.2021 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVË. .......... 12

1.9-INFORMACION STATISTIKOR MBI ÇESHTJET PENALE QE LIDHEN ME PROCESIN E VERIFIKIMIT TE INTEGRITETIT TE PERSONAVE QE ZGJIDHEN, EMEROHEN, OSE USHTROJNE FUNKSIONE PUBLIKE. .......... 15

1.10-TË DHËNA PËR TEMAT DHE NUMRIN E TRAJNIMEVE TË PROKURORËVE DHE OFICERËVE TË POLICISË GJYQËSORE APO TË PËRBASHKËTA ME POLICINË E SHTETIT. .......... 16

1.11-PROBLEMATIKAT E HASURA .......... 16

**II-ANALIZA E TREGUESVE TË KRIMINALITETIT DHE TË PUNËS SË PROKURORISË** .......... **18**

2.1-VOLUMI I PUNËS .......... 18

2.2-TË DHËNA NË LIDHJE ME NJOFTIMET PËR VEPRAT PENALE .......... 18

2.3-TREGUESIT KRYESORË TË PUNËS SË PROKURORISË .......... 20

2.3.1-ÇËSHTJE TË MOSFILLUARA .......... 22

2.3.2-PROCEDIMET PENALE TË BASHKUARA ........ 23
2.3.3-PROCEDIME PENALE TË TRANSFERUARA ........ 24
2.3.4-PROCEDIME PENALE TË PUSHUARA ........ 24
2.3.5-ÇËSHTJE TË PEZULLUARA ........ 28
2.3.6-PROCEDIMET PENALE TË DËRGUARA PËR GJYKIM ........ 29
2.3.7-TREGUESIT E ARRESTIMEVE NË FLAGRANCE DHE NDALIMEVE ........ 33
2.3.8-TË DHËNA PËR FAZËN E E EKZEKUTIMIT ........ 35
2.4-KRIMINALITETI SIPAS SHTRIRJES TERRITORIALE TË NJËSIVE ADMINISTRATIVE NË KOMPETENCË TË PROKURORISË. ........ 36
**III-TREGUESIT STATISTIKORË 2 VJECARE TË VEPRAVE PENALE ........ 37**
3.1-KRIMINALITETI SIPAS PESHËS/PËRHAPJES SË VEPRAVE PENALE DHE TENDENCAVE TË TYRE DHE KRIMINALITETI SIPAS STRUKTURËS SË KODIT PENAL (KRIME - KUNDËRVAJTJE). ........ 37
**IV-ANALIZA E TREGUESVE TË EFEKTIVITETIT TË PUNËS SË PROKURORISË ........ 40**
4.1-TREGUESI I EFEKTIVITETIT NË GJYKIMIN DHE NË DENIMIN E TË PANDEHURVE ........ 40
4.2-TË DHËNA PËR GJYKIMET E POSAÇME ........ 40
4.3-TË DHËNA MBI LLOJET DHE MASAT E DËNIMEVE ........ 41
4.4-TENDENCA E KRIMINALITETIT SIPAS MOSHËS, VENDBANIMIT, ARSIMIT DHE SEKSIT ........ 42
**V-TË DHËNA LIDHUR ME MARRËDHËNIET JURIDIKSIONALE ME AUTORITETET E HUAJA ........ 44**
**VI-TË DHËNA PËR NGARKESËN E PUNËS SË PROKUROREVE DHE OFICERËVE TË POLICISË GJYQËSORE .45**
**VII-INFORMACION MBI ADMINISTRIMIN E PROKURORISË ........ 49**
**VIII-DREJTIMET DHE PËRPARËSITË NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT PËR VITIN 2021 DHE REKOMANDIME ........ 53**
**IX-DREJTIMET DHE PËRPARËSITË NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT PËR VITIN 2022 DHE REKOMANDIME ........ 56**
**X-DREJTIMET DHE PËRPARËSITË E PROKURORISË LEZHË PËR VITIN 2022 ........ 58**
**XI-MARRËDHËNIET ME MEDIAN DHE PUBLIKUN ........ 59**
**NË VEND TË MBYLLJES. ........ 60**
***Shtojcë:Tabelat e treguesve statistikor 2 vjeçar të veprave penale sipas strukturës së Kodit Penal* ........ 61**

# HYRJE

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë nëpërmjet këtij raporti paraqet tek Prokurori i Përgjithshëm dhe trupa e prokurorëve raportin vjetor mbi ecurinë e punës në këtë prokurori për vitin 2021. Ky raport vjetor paraqitet në përmbushje të detyrimeve ligjore, neni 50 i ligjit nr.97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë së Republikës së Shqipërisë".

Prokurorët dhe Oficerët e Policisë Gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë, gjatë vitit 2021, kanë ushtruar funksionet e tyre në respektim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Marrëveshjeve Ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, ligjeve proceduriale dhe ligjeve materiale në fuqi, duke pasur prioritet respektimin e të Drejtave të Njeriut, në frymën e ndryshimeve ligjore të bëra në kuadër të reformës në drejtësi. Prokurorët, Oficerët e Policisë Gjyqësore dhe punonjësit e administratës së Prokurorisë Lezhë kanë vepruar në respektim të Marrëdhënieve Ndërinstitucionale, në respektim të Kodit të Etikës, si dhe në zbatim të Udhëzimeve të Përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm, duke treguar kujdes për ushtrimin sa më mirë të kompetencave kushtetuese dhe ligjore të prokurorit, forcimit të ligjshmërisë dhe efektivitetit në luftën kundër kriminalitetit, duke treguar më shumë profesionalizëm dhe efikasitet në ushtrimin e funksioneve të tyre.

Funksionet e prokurorit për vitin 2021, ashtu si dhe në vitin e kaluar, janë ushtruar duke u fokusuar dhe respektuar "pavarësinë e brendshme të çdo prokurori për hetimin dhe ndjekjen penale". Nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë janë nxjerrë Udhëzime të Përgjithshme në kuadër të zbatimit të ligjit, apo zbatimit të Udhëzimeve të Përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm, me qëllim zbatimin e unifikuar apo unfikimin e praktikave ligjore të ndryshme, por pa cënuar në asnjë rast "pavarësinë e prokurorit të çështjes". Funksionet e prokurorit nga secili prokuror janë ushtruar duke u përpjekur që krahas objektivave të tjera dhe për të rikthyer besimin e publikut te drejtësia, ku forca e ligjit vlen për të gjithë në mënyrë të barabartë, në përmbushje dhe respekt të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Në punën e përditshme të prokurorit kanë gjetur aplikim institutet e reja, të parashikuara në kuadër të ndryshimeve që i janë bërë Kodit të Procedurës Penale, si urdhëri penal, gjykimi me marrëveshje, gjykimi i drejtpërdrejtë etj. Gjithashtu nga ana e trupës së prokurorëve është bërë përpjekje për një përfaqësim sa më cilësor të prokurorit në këto gjykime. Në lidhje me aplikimin e gjykimit me marrëveshje, si dhe të urdhërit penal, rastet e aplikimit nuk kanë qenë në nivelin e pritshëm, pasi për sa i përket institutit të gjykimit me marrëveshje nga ana e të pandehurve apo avokatëve të tyre mbrojtës pranohet marrëveshja, por kryesisht është refuzuar nga gjykata.
Një rëndësi të veçantë, duke i kushtuar vëmëndje të diferencuar në cilësinë e drejtuesit, ka patur ushtrimi i funksionit të prokurorit në përputhje me standartet më të larta etiko-morale. Pavarësisht ngarkesës së lartë dhe kushteve të vështira, prokurorët kanë treguar disiplinë të lartë në respektimin

dhe paraqitjen në seanca gjyqësore, në datën dhe orën e caktuar, por dhe në mënyrën e komunikimit me gjykatën dhe subjektet e tjerë procedural, duke patur në focus garantimin e të drejtave të viktimës së veprës penale, shqyrtimin në afat të kërkesave për informacion, si dhe krijimin e aksesit të nevojshëm publikut.

Në funksion të përmbushjes së detyrave, rol të rëndësishëm luan dhe administrata e prokurorisë e cila bën të mundur përgatitjen e materialeve dhe praktikave të dosjeve për në gjykatë, si dhe përmbush një sërë detyrash të tjera që lidhen me punën e prokurorit, gjë e cila ka mundësuar realizimin dhe përmbushjen në kohë të detyrave të prokurorisë.

Qëllimi kryesor i analizës vjetore të punës, sikurse parashtrohet në vijim, është që të evidentojë objektivat e arritura, problematikat e shfaqura, në mënyrë që në vijim të shfrytëzohen si katalizator pozitiv në përmirësimin e rezultave, dhe rritjen e efiçencës..

Ngarkesa që kanë përballuar në punë për këtë vit, treguesit e shënuar në të gjitha drejtimet, lidhur me ushtrimin e ndjekjes penale dhe përfaqësimin në gjykim, vënien në ekzekutim të vendimeve gjyqësore, mbikqyrjen e ekzekutimit të vendimeve penale, si dhe ushtrimin e detyrave të tjera të ngarkuara me ligj, flasin për punë me ndjenjë përgjegjësie, nga të gjithë prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore dhe administrata e kësaj prokurorie.

Rritja e cilësisë së hetimit, shkurtimi i afateve hetimore, zbatimi i instituteve të reja proceduriale të së drejtës, unifikimi i praktikave, për çështje që nga pikëpamja e kualifikimit ligjor kanë gjetur zgjidhje të ndryshme në praktikën gjyqësore etj, na bëjnë që të synojmë përmirësimin e këtyre treguesve në vitin në vazhdim.

Më lejoni që në vijim të parashtroj, konkretisht, treguesit e punës për vitin 2021, referuar të dhënave mbi punën e këtij institucioni, sa më poshtë vijon:

# I-DREJTIMET DHE PËRPARËSITË NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT PËR VITIN 2021

## 1.1-RESPEKTIMI I TË DREJTAVE TË NJERIUT

Nga ana e Prokurorëve dhe Oficerët e Policisë Gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë gjatë vitit 2021, në ushtrimin e funksioneve të tyre, rëndësi të veçantë i kanë kushtuar respektimit të të drejtave themelore të njeriut, duke respektuar parimet e procedimit të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor, në mbrojtje të të drejtave, interesave dhe lirive të ligjshme të të dëmtuarve dhe dëshmitarëve, ashtu edhe të të dyshuarve, personave nën hetim, të pandehurve dhe të dënuarve. Kodi i Procedures Penale i ka dhënë statusin e subjektit të procedimit penal viktimës së veprës penale.

Në këtë aspekt respektimi i të drejtave të viktimave të krimit në përgjithësi, dhunës në familje, dhunës seksuale, ndihma ndaj personave me aftësi të kufizuara kur janë pjesëmarrës në procedim, etj, kërkojnë angazhim dhe thellim të njohurive jurisprudenciale dhe doktrinare, në funksion të rritjes së vazhdueshme profesionale të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore. Ajo që duhet theksuar është nevoja për përmirësim të infrastukturës së institucionit të prokurorisë, si dhe burimeve njërëzore. Në zbatim të standarteve më të lartë për viktimat e mitur duhet të krijohen një zyrë e posaçme e përshtatshme për praninë e tyre.

Nga ana e prokurorëve në procesin penal janë mbajtur parasysh vecanërisht të drejtat e viktimave dhe dëshmitarëve dhe detyrimet ndaj tyre, në kuadrin e risive që legjislacioni procedurial penal ka njohur. Prokurori, punonjësi i policisë gjyqësore dhe personeli i prokurorisë kanë mbajtur në vëmendje nevojën për privatësi të viktimave dhe dëshmitarëve vecanerisht në cështjet penale me të mitur.

Gjatë përmbushjes së detyrës së tyre prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore kanë vepruar në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Konventen për të Drejtat Themelore të Njeriut, si dhe ligje të tjera që garantojnë këto të drejta.

Gjatë vitit 2021 nuk ka patur apo janë evidentuar raste të shkeljes apo cënimit të këtyre të drejtave.

Gjatë të gjithave fazave të procesit penal janë respektuar të gjitha detyrimet proceduriale dhe ato që kanë lidhje me të drejtat e njeriut. Nuk ka patur zgjatje të pajustifikuara të hetimit.

Zgjatja e afateve të hetimeve paraprake për periudhën 01.01.2021-31.12.2021 ka qënë si më poshtë:

Deri në tre muaj: 114 cështje me 152 të pandehur.

Mbi tre muaj deri në gjashtë muaj: 44 cështje me 77 të pandehur.

Mbi gjashtë muaj deri në nëntë muaj: 14 cështje me 31 të pandehur.

Mbi nëntë muaj deri në një vit: 15 cështje me 35 të pandehur.

Mbi një vit: 15 cështje me 24 të pandehur.

Në lidhje me zgjatjet e afateve të hetimeve paraprake janë bërë 3 ankime ku gjykata për të tre këto ankime ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të prokurorit për zgjatje afati.

Janë respektuar dispozitat proceduriale që parashikojnë të drejtat e palëve në procesin penal. Janë marrë në shqyrtim dhe janë vlerësuar kërkesat apo memot e bëra me shkrim qe palët kanë paraqitur gjatë hetimit paraprak.

Për institucionit tonë nuk ka patur ndonjë Rekomandim të bërë nga Avokati i Popullit për vitin 2021. Gjatë ushtrimit të funksioneve për vitin 2021 Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë ka përmbushur detyrimin ligjor duke dhënë në kohë informacion për sa është kërkuar nga Institucioni i Avokatit të Popullit.

## 1.2-TË MITURIT DHE GRUPET VULNERABËL, SI TË PANDEHUR DHE VIKTIMA

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë është e angazhuar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe në mënyrë të veçantë për të zbatuar më tej politikat e antidiskriminimit, përmirësimin e gjendjes me të drejtat sociale, me fokus të veçantë te grupet vulnerabël dhe të miturit.

Në nenin 68 të ligjit nr.97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë" është parashikuar detyrimi i prokurorisë për të garantuar shërbimet e nevojshme për trajtimin e subjekteve që gëzojnë status të posaçëm. Çdo Prokurori, sipas ligjit duhet të ketë në përbërje të saj të paktën një koordinator, të diplomuar në psikologji, sociologji ose fusha të tjera të posaçme.

Të miturit në sistemin e drejtësisë penale përbëjnë një kategori vulnerabël, ndaj edhe mbrojtja e tyre përbën një ndër objektivat strategjikë më të rëndësishëm të reformës në sistemin e drejtësisë penale. Garantimi i drejtësisë miqësore dhe realizimi i interesit më të lartë të fëmijës është qëllimi i ndryshimeve ligjore dhe synimi që kërkohet të realizohet.

Në këtë kuadër, reforma në drejtësi ka përmirësuar dukshëm legjislacionin penal lidhur me të drejtat e viktimës dhe të fëmijëve në funksion të garantimit të procesit të rregullt ligjor për të miturit dhe gratë viktima të dhunës në familje. Ligji nr. 35/2017, i cili parashikon ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale, synon ta përafrojë legjislacionin procedural penal me standardet më të mira ndërkombëtare të parashikuara nga instrumentet ndërkombëtare në të cilat shteti shqiptar bën pjesë dhe synon të aderojë, si Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, standardet e vendosura nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Gjykata e Drejtësisë, acquis communautaire të Bashkimit Evropian, Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të

Fëmijëve, etj., Këto ndryshime kanë përcaktuar konceptin e “viktimës” dhe “viktimës akuzuese”, duke shtuar figura të posaçme “viktimën e mitur” dhe “viktimën e abuzuar seksualisht apo subjekt të trafikimit”; si dhe duke dhënë dhe përkufizimet dhe rregullimet për këto subjekte, duke plotësuar dhe të drejtat e tyre në përputhje me vendimin kuadër të 15 marsit 2001 mbi qëndrimin e viktimave në procedimet penale, zëvendësuar më tej nga direktiva 2012/29/BE..

Kuadri ligjor për të miturit është plotësuar me ligjin nr. 37/2017 “Kodi i Drejtësisë për të Mitur”, i cili ka për qëllim mbrojtjen e interesit më të lartë të të miturit, integrimin social të tyre, rehabilitimin e të miturve në konflikt me ligjin, mbrojtjen e të drejtave të të miturve dëshmitarë dhe viktima, parandalimin e viktimizimit dytë (riviktimizimit), parandalimi në kryerjen e veprës penale dhe sigurimi i rendit publik gjatë administrimit të drejtësisë. Kodi i Drejtësisë për të Mitur parashikon norma specifike procedurale për organet përgjegjëse gjatë procedurës së administrimit të drejtësisë; norma specifike procedurale që duhet të respektohen në proceset penale që afektojnë fëmijët, si dhe rregulla të posaçme për ekzekutimin e vendimeve dhe masa të tjera alternative.

Po kështu, hyrja në fuqi më 1 Janar 2018 e ligjit nr.37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”, kërkojnë angazhim për rritjen e profesionalizmit të organeve kompetente në administrimin e çështjeve të drejtësisë penale për të mitur. Në çdo fazë të procedimit penal me të miturit në konflikt me ligjin, si dhe gjatë pyetjes së të miturit viktimë ose dëshmitar, pavarësisht nga mosha mbi ose nën 14 vjeç, prania e psikologut është e detyrueshme. Aktualisht, në strukturën e institucionit nuk kemi psikolog, por kordinator për asistencën ndaj subjekteve me status të posaçëm.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë ka vlerësuar maksimalisht edhe fenomenin e dhunës në familje, duke e referuar atë si objektiv në programin qeverisës të saj 2017–2021, nëpërmjet programeve, iniciativave dhe strategjive për adresimin më të mirë të rasteve të dhunës në familje.

Me qëllim garantimin e të drejtave të të gjitha subjekteve të procedimit penal, me fokus të miturit dhe viktimat e dhunës në familje, si një garanci e shtuar lidhur me respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut përgjatë procesit penal, është e domosdoshme që këto ndryshime të rëndësishme ligjore të njihen dhe të zbatohen nga oficerët e policisë gjyqësore dhe prokurorët. Është e nevojshme rritja e profesionalizmit nëpërmjet trajnimeve specifike dhe përmbushja e detyrimeve ligjore prej tyre nëpërmjet zbatimit korrekt të ligjit.

Përsa I përket të miturve në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë raportojmë të dhënat si më poshtë:

Në lidhje me procedimet penale me persona të mitur të përfshirë, rezulton se janë hetuar gjatë vitit 2021, 63 referime penale, me persona të mitur, si të mitur në konflikt me ligjin 60 procedime penale, dhe të mitur viktima 4 procedime penale (*një procedim penal ka të mitur autor dhe të mitur viktimë*). Nga këto në 13 raste është vendosur mosfillimi i procedimit penal. 13 procedime janë pushuar pasi është marrë masa e shmangies nga përgjegjësia penale për të miturit. Ndërsa në 1 rast procedimi është pushuar për shkaqe të tjera ligjore.

Janë dërguar për gjykim 14 cështje me të mitur në konflikt me ligjin, me 9 përsona të pandehur të mitur, 13 (trembëdhjetë) cështje për veprën penale të parashikuar nga neni 291, 7 të mitur në grupmoshën 16-18 vjec, dhe 2 të grupmoshës 14-16 vjec. Një i mitur në konflikt me ligjin është dërguar për gjykim për veprën penale të parashikuar nga neni 101/2 i K.Penal me masë sigurimi «Arrest në burg », i grupmoshës 16-18 vjec.

Për të miturit në përgjithësi nuk janë zbatuar masa sigurimi, kemi 5 të pandehur të mitur në konflikt me ligjin për të cilë janë zbatuar masat e sigurimit si më poshtë :

- 2 të mitur në konflikt me ligjin janë hetuar me masë sigurimi « Detyrim për t'u paraqitur në policinë gjyqësore » .
- 2 të mitur në konflikt me ligjin janë hetuar me masë sigurimi « Arrest në shtëpi »
- 1 i mitur në konflikt me ligjin hetuar me masë sigurimi « Arrest në burg » .

## 1.3-BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL

Objektivi kryesor i punës së prokurorisë mbetet rritja e efektivitetit të hetimit dhe vënia përpara përgjegjësisë penale e përsonave që shkelin ligjin. Përmbushja e këtij objektivi varet jo pak nga bashkëpunimi me institucionet dhe strukturat e tjera ligjzbatuese me të cilat lidhet puna e prokurorisë. Në luftën kundër kriminalitetit bashkëpunimi dhe koordinimi është thelbësor në ngritjen e një çështje penale. Për këtë arsye forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional gjatë vitit 2021 për Prokurorinë Lezhë ka qenë prioritar.

Përgjatë gjithë vitit 2021, janë realizuar takime të përbashkëta, janë shkëmbyer informacione, janë mbajtur raporte korrekte me institucione dhe struktura ligjzbatuese, me të cilat lidhet ngusht puna e prokurorisë, në zbatim të ligjit procedural penal dhe ligjit organik për prokurorinë.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë, gjatë vitit 2021, ka patur kryesisht marrëdhënie, por jo vetëm, me:

- Prokurorinë e Përgjithshme, me të gjitha drejtoritë, e organizuara pranë Prokurorisë së Përgjithshme;
- Me Këshillin e Lartë të Prokurorisë;
- Inspektoriatin e Lartë të Drejtësisë.
- Komisionin e Paverur të Kualifikimit.
- Strukturat e Policisë së Shtetit, Drejtorinë Vendore të Policisë Lezhë dhe Komisariatet Lezhë dhe Mirditë, që ushtrojnë funksionet në territorin ku shtrin kompetencat Prokuroria Lezhë;
- Me të gjitha institucionet e tjera që kanë organizuar shërbime të policisë gjyqësore, dhe kanë referuar materiale hetimore në Prokurorinë Lezhë;
- Me Gjykatën e Shkallës së Parë Lezhë, për fazën që lidhet me kërkimet e bëra gjatë hetimit paraprak, në seance paraprake, me përfaqesimin e akuzës në gjykim, etj;
- Me Prokurorinë dhe Gjykatën e Apelit Shkodër, për fazen që lidhet me çështjet penale të ankimuara;

- Me IEVP – Shënkollë, Lezhë;
- Me IEVP – Reç, Malësi e Madhe;
- Me Zyrën e Shërbimit të Provës;
- Me Zyrën e Përmbarimit
- Me Institucione të tjera në nivel lokal.

### 1.3.1-RAPORTET ME PROKURORINË E PËRGJITHSHME DHE ME KËSHILLIN E LARTË TË PROKURORISË. ZBATIMI I UDHËZIMEVE TË PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM

Gjatë vitit 2021 ka patur një bashkëpunim mjaft të mire me të gjitha Drejtoritë në Prokurorinë e Përgjithshme, si dhe me Këshillin e Lartë të Prokurorisë. Ky bashkëpunim i ka shërbyer shumë punës së perditshme, përmiresimit të parametrave tregues dhe realizimit te objektivave të veprimtarisë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë. Bashkëpunimi është arritur duke patur interesimin e Prokurorit të Përgjithshem të Republikes së Shqipërisë, por jo vetem, interesimi ka qene i vlerësueshëm edhe për të gjitha strukturat e tjera të Prokurorisë së Përgjithshme, si Kabineti, Drejtoria Gjyqësore, Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë, Drejtoria e Përgjimeve të Telekomunikimeve dhe Marrëdhënieve me Shërbimet Informatore, Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetese etj.

Ndryshimet ligjore në aspektin e organizimit dhe funksionimit të Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë, ligjet e tjera të reformës në drejtësi të miratuara gjatë viteve 2016 - 2017, kane çuar ne ndryshime të ndjeshme, për zbatimin e unifikuar të të cilëve nga prokurorite në vend ishte domosdoshmëri nxjerrja e udhezimeve të përgjithshme. Udhëzimet e Përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm na kanë ndihmuar në punën tone të përditshme. Këto Udhëzime i kanë shërbyer zbatimit uniform të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, si dhe kanë qenë një ndihmë për të unifikuar zbatimin e ligjit, duke patur në konsiderate faktin që në një sërë ligjesh që zbatohen në punën e përditshme të prokurorit ka patur ndryshime të karakterit thelbësor. Këto Udhëzime kanë kontribuar në forcimin e ligjshmërisë dhe efektivitetit te punës së përditshme të prokurorëve. Prokurorët dhe Oficerët e Policisë Gjyqësore kanë vepruar në përputhje me sa udhëzohet në Udhezimet e Përgjithshme të Prokurorit të Përgjitshëm.
Përgjithësisht Udhëzimet e Përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm janë zbatuar drejtpërdrejt, por për disa prej tyre, me qëllim zbatimin e tyre në përputhje me burimet dhe kapacitet e Prokurorisë Lezhë, nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë janë nxjerrë udhëzime të përgjithshme të brendshme. Krahas Udhëzimeve të kësaj natyre nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë Lezhë, janë nxjerrë udhëzime të përgjithshme, në zbatim të ligjit.

### 1.3.2-RAPORTET ME STRUKTURAT E POLICISË SË SHTETIT

Gjatë vitit 2021 bashkëpunimi me të gjitha strukturat e policisë së shtetit, që veprojnë në Qarkun e Lezhës, si Drejtoria Vendore e Policië Lezhë, Komisariatet e Policisë, Lezhë dhe Mirditë, ka qënë mjaft i mirë dhe rezultativ. Ne kuadër të këtij bashkëpunimi është mundësuar respektimi me rigorozitet i detyrimeve ligjore në funksion të rritjes së cilësise dhe shpejtësisë së hetimeve paraprake. Janë realizuar takime periodike dhe analiza të përbashkëta me Policinë e Shtetit dhe institucionet e tjera ligjzbatuese, qoftë në nivel drejtuesish institucionesh, qoftë në nivel prokurori.

Pjesa më e madhe e procedimeve penale janë regjistruar mbi bazën e materialeve hetimore të referuara nga shërbimet e policisë gjyqësore të Policisë së Shtetit. Si rregull veprimet hetimore, prej prokurorëve të ngarkuar me hetimin e këtyre çështjeve penale, janë deleguar po tek oficerët e policise gjyqësore, të shërbimeve përkatese. Në disa raste kur ka patur levizje të oficerëve të policisë gjyqësorë në detyrë, apo për oficerë të policisë gjyqësorë që ushtrojnë detyrën me kohë të pjeshme, delegimi i veprimeve hetimore është bëre tek oficerët e policisë gjyqësore të Seksionit të Prokurorisë.

Pranë Prokurorisë Lezhë kryejnë funksionin e tyre si oficerë të policisë gjyqësore gjashtë oficerë. Është rritur cilesia dhe niveli i hetimeve paraprake të kryera nga shërbimet e policisë gjyqësore dhe po kështu është rritur përgjegjshmëria e oficerëve të policisë gjyqësore, në raport me procedimin penal që u delegohet për hetim. Materialet hetimore, me veprime të ngutshme, referohen në kohë. Po kështu ka patur një koordinim të mirë ndërmjet prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore, në aspektin e të vepruarit në kohë, në rastet e hetimeve proaktive apo hetimeve që lidhen me asetet kriminale.

### 1.3.3-RAPORTET ME GJYKATËN E SHKALLËS SË PARË LEZHË

Raportet me Gjykatën e Shkallës së Parë Lezhë kanë qenë korrekte dhe ligjore, në të gjitha fazat e përfaqësimit të prokurorisë në gjykim. Këto raporte korrekte dhe ligjore shfaqen si në kërkesat që lidhen me fazën e hetimit paraprak, tek gjyqtari i seancës paraprake, në përfaqësimin e akuzës në gjyq, në gjykimin e procedimeve penale, si dhe në gjykimet ku objekt janë kërkesat në fazën e ekzekutimit të vendimeve penale. Prokurorët kanë respektuar me korrektesë pjesëmarrjen në gjykim, nuk ka patur shtyrje apo zvarritje të pajustifikuara të proceseve gjyqësore, me përjashtim të seancave gjyqësore, për të cilat kanë patur përplasje në orar. Nga prokurorët është respektuar e solemniteti në gjykim.

### 1.3.4-RAPORTET ME PROKURORINË E APELIT SHKODËR

Me Prokurorinë e Apelit Shkodër ka patur një komunikim të vazhdueshëm dhe shumë të ngushtë si dhe me parë, në funksion të përfaqësimit sa më cilësor të akuzës në ceshtjet e ankimuara. Si rezultat i një komunikimi të tillë është bërë e mundur që të njihen dhe trajtohen më mirë problematikat që lidhen me përfaqesimin e akuzës në çështjet e ankimuara.

Nga ana jonë është vazhduar ndjekja e praktikës që apelimet e prokurorëve të shkallës së parë, si për masat e sigurimit dhe për vendimet përfundimtare, krahas depozitimit në gjykatë dërgohen paralelisht për njoftim edhe në Prokurorinë e Apelit, po ashtu edhe njoftimi që Prokuroria e Apelit i dërgon kësaj zyre për vendimet përfundimtare në shkallën e dytë të gjykimit, për cdo tremujor.

Në funksion të këtij qëllimi është edhe organizimi i takimeve periodike, nga Drejtuesi i Prokurorisë së Apelit dhe prokurorët e kësaj prokurorie, me Drejtuesin dhe prokurorët e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë, për njohjen dhe trajtimin e problemeve të hasura në çështjet e ankimuara.

### 1.3.5-RAPORTET ME GJYKATËN E APELIT SHKODËR

Raportet e Prokurorisë Lezhë me Gjykatën e Apelit Shkodër kanë qenë tepër të kufizuara, pasi përfaqesimi i akuzës në Gjykatën e Apelit është kryer nga Prokurorët në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Shkodër. Gjithsesi në raste të caktuara nuk ka munguar edhe komunikimi me gjyqtarë të Apelit Shkodër për çeshtje konkrete të cilat kanë marrë zgjidhje ligjore.

### 1.3.6-RAPORTET ME INSTITUCIONET E TJERA VENDORE

Është bashkëpunuar me institucione të tjera si Prefektura Lezhë, Bashkitë, që gjenden në territorin e Qarkut të Lezhës ( Lezhë dhe Mirditë), në aktivitete që i shërbejnë parandalimit të përhapjes së veprave penale, sikurse janë ato në fushën e kultivimit dhe shpërdarjes së lëndëve narkotike, dhunës në familje etj. Në kuadër të bashkëpunimit me institucionet në Lezhë është edhe miratimi i një Marrëveshje Bashkëpunimi e “Mekanizmit të bashkërëndimit të punës për referimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës në marrëdhënjet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij”. Kjo marrëveshje bashkëpunimi është iniciuar nga punonjësit e Shërbimit Social pranë Bashkisë Lezhë dhe është nënshkruar nga të gjithë përfaqësuesit e Institucioneve të Qarkut Lezhë. Marrëveshja për ngritjen e Task-Forcës për “parandalimin dhe goditjen e kultivimit të narkotikëve” marrëveshje e nënshkruar ndërmjet Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë, Prefektit të Qarkut Lezhë si dhe institucioneve të tjera të pushtetit Vendor, SHISH dhe Drejtorisë Vendore të Policisë

Lezhë. Në lidhje me këtë marrëveshje janë bërë takime të organizuara nga Prefekti i Qarkut Lezhë ku janë evidentuar problematikat në rrethin e Lezhës përsa i përket kultivimit të bimëve narkotike. Në këto takime është ngritur nevoja e bashkëpunimin ndërinstitucional për luftimin e këtij fenomeni.

Është bashkëpunuar me I.E.V.Penal Shënkoll Lezhë, ku ndërmjet dy institucioneve është nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi në fushën e komunikimeve eletronike, e cila është zbatuar me rogorozitet nga të dy palët, me qëllim rritjen e efikasitetit dhe shpejtësisë në komunikimin ndermjet palëve, komunikim i cili dokumentohet dhe shoqërohet edhe në formë shkresore.

## 1.4-BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë gjatë vitit 2021 ka mbajtur një komunikim të vazhdueshëm me Drejtorinë e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme, në lidhje shpalljet në kërkim ndërkombëtar, në lidhje me letërporosi të mbërritura nga jashtë shtetit dhe të nisura për jashtë shtetit, ekstradimet, etj.

## 1.5-PËRDORIMI I METODAVE SPECIALE TË HETIMIT DHE HETIMET PROAKTIVE.

Në luftën kundër kriminalitetit, organi i prokurorisë është angazhuar maksimalisht në përdorimin e metodave speciale hetimore dhe në ndërmarrjen e hetimeve proaktive, duke bashkëpunuar me të gjithë institucionet e tjera ligjzbatuese.

Janë filluar disa çeshtje penale në bazë të informacioneve duke përdorur metoda speciale të hetimit, hetime proaktive, kryesisht përgjimi, autorizime për përdorimin e metodave special për hetimin e veprave penale kundër korrupsionit si dhe për hetimin e krimeve kundër jetës, të kryera me dashje, ku si rezultat i përdorimit të këtyre metodave është arritur një rezultat shumë i kënaqshëm ku janë arrestuar disa persona kryesisht me lëndë plasëse dhe me lënde narkotike, krime kundër jetës etj.

Nga ana e prokurorisë janë bërë 19 kërkesa për lejim përgjimi nga të cilat 18 janë pranuar dhe 1 është rrëzuar nga gjykata e shkallës së parë, për këtë është ushtruar ankim nga prokurori, Gjykata e Apelit ka pranuar ankimin dhe lejimin e përgjimit.

Nga ana e prokurorisë janë bërë 4 kërkesa për zgjatje afati të përgjimit nga të cilat vetëm 1 kërkesë është rrëzuar.

Gjithashtu nga ana e prokurorisë janë bërë 3 kërkesa për lejim kontroll banese të cilat në të tre rastet janë pranuar nga gjykata.

## 1.6-INFORMACION MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Gjatë vitit 2021, në punën e përditshme të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore, kanë gjetur zbatim Rekomandimet Prioritare "Në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2021", miratuar nga Këshilli i Ministrave. Ka patur një bashkëpunim të frytshëm me Policinë e Shtetit dhe me agjensitë e tjera ligjzbatuese. Ka patur një rritje të hetimeve proaktive dhe përdorim të teknikave speciale të hetimit, përmirësim të cilësisë së hetimit.

Ka patur ulje të numrit të referimeve për veprën penale të "*Pastrim i produkteve të veprës penale*", që parashikohet nga neni 287 i Kodit Penal, 17 procedime penale të regjisruara në vitin 2021, ku për 3 procedime është kërkuar pushimi I hetimeve, 1 procedim me një të pandehur të arrestuar është dërguar për gjykim, pjesa tjetër vijon të jenë në hetim. Numër pothuajse të njëjtë të hetimeve pasurore për vitin paraardhës dhe për vitin 2021. Për **6 procedime** penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 287 I K Penal,**vazhdojnë paralelisht hetimet pasurore për shtetasit e dyshuar**. Për llogari të një procedimi penal ështe bërë vendosja e sekuestros preventive mbi pasuritë dhe aktivitetet tregtare. Në këtë rast nuk është bërë vlerësimi në total I aseteve të sekuestruara. Gjykata ka pranuar tërësisht kerkesen për sekuestro.

Hetimet pasurore rezultojnë të jenë referuar më së shumti nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit e cila vlen të theksohet se kanë një përmirësim në referimet e paraqitura pasi rezultojnë më të plota dhe më serioze në verifikimet dhe aktet e para procedurale të administruara fakt që do të ndihmojë dhe ndikojë në kryerjen e hetimeve më cilësore në këtë drejtim.

Janë vlerësuar drejt kushtet dhe kriteret e vendosjes së masave të sigurimit, kërkesat për masat e dënimit në gjykim, në përputhje me këto rekomandime.

Ka një ashpërsim të politikës së dënimit për veprën penale të dhunës në familje.

Gjatë vitit 2021 ka patur një fokusim në hetimin ndaj subjekteve që bëjnë evazion fiskal.

## 1.7-INFORMACION MBI ZBATIMIN E REZOLUTËS SË KUVENDIT DATË 17.06.2021 "PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË PROKURORISË"

Në kuadër të rezolutës së mësipërme, vlerësoj se një pjesë e konsiderueshme e kërkesave të parashtruara në rezolutën e Kuvendit janë përmbushur nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë në përputhje me juridiksionin e saj dhe kompetencën lëndore e territoriale. Disa prej kërkesave të rezolutës janë faktikisht rubrika dhe gjetje më vete të këtij raporti siç është:

1. Rritjen e rolit aktiv të prokurorit në hetimin paraprak, në funksion të shtimit të hetimeve të filluara kryesisht nga vetë organi i prokurorisë.

2. Forcimi koordinimi dhe monitorimi i ecurisë së zbatimit të memorandumit të bashkëpunimit dhe udhëzimit të përgjithshëm nr.10/2020, për rritjen më tej të efiçencës së veprimtarisë ndërinstitucionale dhe të efektivitetit në hetimet dhe ndjekjen penale të pastrimit të produkteve të veprës penale, financimit të terrorizmit dhe në hetimet pasurore për sekuestrimin dhe konfiskimin e aseteve kriminale, në vijim të zbatimit të planit të veprimit të Grupit të Shqyrtimit të Bashkëpunimit Ndërkombëtar/Grupi i Posaçëm i Veprimit Financiar (ICRG/FATF).

3. Forcimi I kapaciteteve institucionale për rritjen e efiçencës në veprimtarinë administrative të prokurorisë dhe të veprimtarisë së prokurorëve dhe Policisë Gjyqësore në ushtrimin e funksioneve të tyre nëpërmjet vijimit të punës së nisur për shmangien e efekteve të krijuara nga ulja e numrit të prokurorëve për shkak të procesit të rivlerësimit kalimtar.

Pavarësisht se konstatojmë që veprimtaria e Prokurorisë ka qenë në përputhje me kërkesat e mësipërme, vlerësojmë se ka vend ende për përmirësimin e treguesve të mësipërm, qëllim ky i cili arrihet jo vetëm me punën e Prokurorisë, por edhe me vullnetin e organeve të tjera shtetërore si Kuvendi, organet e pushtetit ekzekutiv, ministritë dhe institucionet të varësi të tyre, institucionet e tjera të pavarura si KLSH, ILDKPKI etj.

## 1.8-INFORMACION MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE RPIORITARE "PËR LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT PËR VITIN 2021" MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 326, DATË 02.06.2021 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVË.

Në kuadër të rekomandimeve të Këshillit të Ministrave për vitin 2021 vlerësoj se jemi përpjekur për përmbushjen e prioriteteve të parashikuara në rekomandimet e Këshillit të Ministrave. Në këto të fundit, ndër prioritetet janë lufta ndaj korrupsionit dhe krimit të organizuar, respektimi i të drejtave të njeriut dhe bashkëpunimi ndërinstitucional.

i) Në vitin 2021, në kuadër edhe të rekomandimeve, zbatimit të tyre me prioritet, nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë janë regjistruar, 141 procedime penale ne fushën e narkotikeve, si prodhim, mbajtje dhe kultivim. Jane registruar 17 procedime penale per veprën penale të parashikuar nga neni 287 i K.Penal si dhe 42 referime pasurore.

- Për hetimin e këtyre veprave penale janë kryer veprime proaktive gjatë ushtrimit të ndjekjes penale, kryesisht duke përdorur format e përgjimit telefonik dhe vëzhgimit ambiental, në pjesën më të madhe të procedimeve të mësipërme penale dhe kur është vlerësuar e arsyeshme që një teknikë e tillë hetimi mund të jepte rezultate provuese në hetim. Referimet lidhur me këtë vepër penale janë kryer kryesisht nga Drejtoria Vendore e Policisë Lezhë si; Seksioni për Hetimin e Krimit Ekonomik dhe Financiar, Seksioni për Trafiqet e

Paligjshme dhe Narkotikët, duke i ndjekur dhe me hetime proaktive, për shkak se ka ekzistuar një dinamikë e caktuar për ngjarjet e referuara.

- Lidhur me aksesin e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore të seksionit në database shtetërore mundësohet lidhja nga ana teknike, por aksesi që jepet nuk është në nivelin e duhur për të nxjerrë informacionin e kërkuar. Aktualisht, është në funksion dhe është përmirësuar sistemi lidhur me administrimin e çertifikatës elektronike të gjendjes gjyqësore, E-Albania, Tims, ASHK (të dhënat e hedhura nga ASHK nuk janë të plota dhe pavarësisht aksesit nuk kanë ndihmuar shumë në punën tonë). Nga ana jonë sugjerojmë që akseset në databaza të jenë në nivel të plotë si lexues dhe pa pagesë sepse disa databaza nuk japin informacion pa bërë pagesën paraprakisht dhe kjo sjellë vonesë në hetim.

- Përgjatë vitit 2021, ka vijuar të mbetet problematike mungesa e referimeve për veprën penale të kryera, nga ana e institucioneve të tjera ligjzbatuese, të cilat kanë detyrën funksionale të mbledhjes së informacioneve në këtë drejtim, siç mund të jetë Shërbimi Informativ Shtetëror, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave apo dhe institucione të tjera si Drejtoria e Hetimit Tatimor (9 referime të Drejtorisë së Hetimit Tatimor janë regjistruar në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë për vitin 2021 ndërkohë që në vitin 2020 janë referuar 13 raste nga ky institucion) etj.

- Në drejtim të forcimit të kapaciteteve profesionale të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore në periudhën raportuese kanë munguar trajnimet e përbashkëta me agjensitë ligjzbatuese të përfshira në luftën kundër kriminalitetit.

*ii) Lidhur me zbatimin e rekomandimeve në luftën kundër krimit të organizuar, theksojmë se:*

- Nga ana e prokurorëve të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë janë zhvilluar dhe janë në zhvillimin e sipër hetime të procedimeve penale për veprat penale të pastrimit të produkteve të veprave penale apo veprimtarisë kriminale, si edhe prodhimit dhe shitjes së narkotikëve, kultivimit të narkotikëve.
- Edhe sa u përket rekomandimeve në këtë fushë, vlerësohet e nevojshme rritja e numrit të trajnimeve për prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore.
- Lidhur me zbatimin e planit të Marrëveshjes me Eurojust-in dhe Planit të Veprimit të Prokurorisë së Përgjithshme dhe Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale, nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë Lezhë, në zbatim edhe të shkresës të Prokurorisë së Përgjithshme, është hartuar urdhri "Për emërimin e personit të kontaktit për mbrojtjen e të dhënave personale", duke u caktuar në këtë detyrë një specialis I administratës së prokurorisë nën mbikqyrjen e prokurorit për median, i cili ka për detyrë mbikqyrjen e brendshme të mbrojtjes së të dhënave personale, në përputhje me aktet e mësipërme, urdhrin e Prokurorit të Përgjithshëm nr. 140, datë 03.09.2019 "Për miratimin

e rregullores për mbrojtjen e të dhënave personale në shkëmbimin e informacionit me Eurojust" dhe Udhëzimet e Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

iii) Lidhur me zbatimin e rekomandimeve në fushën e respektimit të të drejtave të njeriut, nga ana e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore kryhen vazhdimisht përpjekje për zbatimin e tyre duke patur gjithnjë në fokus kategoritë vulnerabël që për arsye të ndryshme, bëhen pjesë apo palë të një procesi penal, veçanërisht të miturit, gratë, personat e dhunuar dhe ata me aftësi ndryshe.

- Në drejtim të zbatimit të rekomandimeve në këtë fushë, evidentojmë se janë dërguar në gjykim me procedurën e miratimit të marrëveshjes 19 procedime penale me 19 të pandehur.
- Është mbajtur në konsideratë që për veprat penale dhe autorët me rrezikshmëri të ulët shoqërore, të kërkohen përpara gjykatës zbatimi i dënimeve alternative, ku kryesisht është aplikuar pezullimi i ekzekutimit të vendimit të dënimit me burgim dhe vënia e të pandehurit në provë për një periudhë të caktuar, duke mbajtur kontakte me shërbimin e provës.
- Është treguar kujdes lidhur me aplikimin e masave të sigurimit shtrënguese për të miturit autorë të veprave penale. Në përputhje me parimet e përcaktuara në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur, caktimi i masave të sigurimit shtrënguese për të miturit është konsideruar si masë e fundit, vetëm nëse çdo masë tjetër e parashikuar në këtë Kod nuk është e përshtatshme.
- Janë bërë përpjekje për zhvillimin e hetimeve të shpejta në rastet e çështjeve ku të miturit janë viktima ose autorë të veprave penale. Në këtë drejtim, duhet të mbahet në konsideratë jo vetëm kohëzgjatja e procedurës së hetimit nga ana e prokurorit dhe oficerit të policisë gjyqsore, por edhe kërkesat eventuale të palëve gjatë procesit të hetimit dhe sjellja e tyre.
- Në përputhje me rekomandimet prioritare, janë ashpërsuar kërkesat për aplikimin e masave të sigurimit dhe dënimeve ndaj autorëve të veprave penale të ngacmimit seksual, përndjekjes, dhunës në familje etj.

iv) Lidhur me bashkëpunimin ndërinstitucional, veçanërisht me Policinë e Shtetit, vlerësoj se bashkëpunimi ka qenë korrekt dhe në përputhje me ligjin. Nga të dhënat e pasqyruara në grafik rezulton se për 72 % të procedimeve të hetuara të për vitin 2021 janë hetuar nga oficerët e policisë gjyqësore të seksionit të prokurorisë, dhë 28 % e procedimeve të tjera të hetuara të reja për vitin 2021 janë hetuar nga oficerët e policisë gjyqësore të policisë së shtetit. Kjo është për shkak të volumit të madh të procedimeve dhe lehtësisë që ka prokurori duke e pasur dosjen brënda institucionit të prokurorisë.

- Lidhur me institucionet e tjera ligjzbatuese, por edhe me Policinë e Shtetit, përveç bashkëpunimit korrekt institucional ndërmjet tyre dhe Prokurorisë, konstatohet se mungojnë informacionet dhe referimet nga këto organe për veprat penale të korrupsionit,

gjë që do të mundësonte dhe trajtimin e përshtatshëm, duke përdorur hetimet proaktive për hetimin e tyre.

- Nga verifikimi i kryer **nuk** rezulton se ka pasur raste për materiale të dërguara nga Prokuroria e Përgjithshme në zbatim të ligjit nr. 138/2015 (dekriminalizimi). Për vitin 2021 **nuk** rezulton se është referuar material kallëzues nga KLSH-ja.

## 1.9-INFORMACION STATISTIKOR MBI ÇESHTJET PENALE QE LIDHEN ME PROCESIN E VERIFIKIMIT TE INTEGRITETIT TE PERSONAVE QE ZGJIDHEN, EMEROHEN, OSE USHTROJNE FUNKSIONE PUBLIKE.

Ne vitin 2021, nga Inspektoriati i Larte i Deklarimit dhe Kontrollit te Pasurive dhe Konfliktit te Interesave, ne Prokurorine Lezhë nuk ka patur referime.

Ne vitin 2021, nga Kontrolli i Larte i Shtetit ne Prokurine Lezhë nuk ka pasur referime.

Nga Sektori i Dekriminalizimit ne Prokurorine e Pergjithshme, kete vit nuk ka pasur referime.

Nga Sektori i Dekriminalizimit në Prokurorinë e Përgjithshme, në vitin 2020 është percjellë vetëm një material referues për në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë, të cilat lidhen me procesin e Verifikimit të Integritetit të Personave që Zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike.

Në vitin 2020, nga Inspektoriati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit te Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, në Prokurorine Lezhë janë referuar dy kallëzime penale.

***Tabela e mëposhtme tregon referimet për vitin 2021.***

| **2021** | **KALLEZIME** | **MOSFILLUAR** | **REGJISTRUAR PROCEDIM** | **NENI** | **PERSONA NE HETIM/TE PANDEHUR** | **MENYRA E PERFUNDIMIT** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **ILDKPKI** | - | - | - | - | - | - |
| **KLSH** | - | - | - | - | - | - |
| **DAP** | - | - | - | - | - | - |

## 1.10-TË DHËNA PËR TEMAT DHE NUMRIN E TRAJNIMEVE TË PROKURORËVE DHE OFICERËVE TË POLICISË GJYQËSORE APO TË PËRBASHKËTA ME POLICINË E SHTETIT.

Me gjithë ngarkesën e madhe të punës prokurorët kanë qenë korrekt me ndjekjen e trajnimeve të vazhdueshme, përfshirë dhe ato online . Trajnimet që janë ndjekur kanë qenë ato të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës, Prokuroria e Përgjithshme dhe partnerët si EURALIUS, OPDAT etj

Në kuadër të ndryshimeve ligjore janë realizuar trajnime të oficerëve të policisë gjyqësore me qëllim rritjen e profesionalizimit si dhe përshtatjes së tyre me ndryshimet e reja, por duhet të bëhet më shumë.

## 1.11-PROBLEMATIKAT E HASURA

Problematika kryesore mbetet zgjatja e afateve në hetimin e veprave penale. Kjo ndodh për shkak të ngarkesës shumë të lartë, si dhe numrit të vogël të prokuroreve efektiv. Si shkak për zgjatje të hetimit ka sherbyer edhe vonesa në mberritjen e akteve të ekspertimit kriminalistik, instituti mjekësisë ligjore apo përgjigjeve të kërkuara nga shoqeritë e telefonisë celulare.
Problematike në vetvete përbëjnë dhe referimet jo të sakta të vepres penale nga oficeret e policise gjyqësore, mosnjoftimi i prokurorëve për ngjarjet e ndodhura, marrja jo e saktë e gjeneraliteteve të subjekteve, adresave etj.

Vihen re raste referimi per kryerjen e veprave penale te "*Pastrimit te produkteve te vepres penale*", neni 287 i Kodit Penal, te paplota, pa kryer një minimum verifikimi në lidhje me sa referohet.

Ndryshimet në Kodin e Procedures Penale, si dhe ligjeve të tjera në kuadër të reformës në drejtësi kanë bërë që puna administrative e prokurorit të rritet ndjeshëm.

Në kuadër të ndryshimeve ligjore janë realizuar trajnime të oficerëve të policisë gjyqësore me qëllim rritjen e profesionalizimit si dhe përshtatjes së tyre me ndryshimet e reja, por duhet të bëhet më shumë.

Me ndryshimet e reja të K.Pr.Penale prokurori duhet të bëjë shumë kërkesa në gjykatë ku kjo e fundit vlerëson aktet para përfundimit të çështjes që do të thotë se prokurorët edhe gjatë hetimit dhe para përfundimit të çështjes duhet të shkojnë në gjykatë dhe kontaktet me gjykatën jane shumë më të shpeshta. Gjithashtu gjatë punës konstatohet se gjyqet e caktuara nga gjyqtarët nuk bëhen në orar. Kjo ndodh për shkak të godinës së gjykatës e cila është e vogël dhe nuk ka salla të mjaftueshme për zhvillimin e seancave gjyqësore. Zvarritja e orareve të gjyqeve e mban prokurorin shumë gjatë në ambjentet e gjykatës dhe nga ana tjetër pengon punën në prokurori për hetimin e çështjeve penale.

Një arsye kryesore që përbën shkak për zvarritjen e hetimeve ka qenë edhe situata e Pandemisë.. Edhe gjatë punës, pasi është hapur vendi, takimet kanë qenë të kufizuara për shkak të përhapjes së infeksionit. Disa raste persona nën hetim apo dëshmitarë të cilët nuk kanë mundur të paraqiten në prokurori pasi kanë rezultuar pozitiv ndaj virusit covid-19.

# II-ANALIZA E TREGUESVE TË KRIMINALITETIT DHE TË PUNËS SË PROKURORISË

## 2.1-VOLUMI I PUNËS

Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë në fillim të vitit 2021 kanë ushtruar funksionet e tyre 9 prokurorë së bashku me drejtuesin e prokurorisë. Më pas kjo prokurori është ndeshur me mungesa të prokurorëve në organikën dhe strukturën e saj, mungesa ka ardhur në rritje, ku ; 2 prokurorë janë shkarkuar, 1 prokuror është pezulluar, 2 prokurorë janë transferuar dhe aktualisht 1 prokuror është me raport mjekësor pa afat, momentalisht Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë ka 3 prokuror dhe drejtuesin (i cili ka ngarkesë të limituar) fakt që ka ndikuar në ngarkesën në prokurori, në ngarkesën e çdo prokurori me dosje në hetim dhe gjykim, si dhe në pamundësinë e pasjes së seksioneve. Kjo ka ndikuar edhe në cilësinë e hetimeve, shpejtësinë dhe plotësinë e hetimeve dhe mundësinë e rritjes së efektivitetit dhe evadimit të dosjeve të mbartura në vitet e mëparshme, etj. si dhe 6 oficerë te policise gjyqesore të seksionit të prokurorisë.

Administrata në Prokurorinë prane Gjykates se Shkalles se Pare Lezhë përbëhet nga 9 punonjës dhe shërbimet ndihmëse nga 2 punonjës.

Çeshtjet penale janë nominuar me anë të shortit elektronik, ndërsa në rastet e hetimeve pasurore apo fashikujve të cështjeve penale të pezulluara për të cilat është përmbushur afati i parashkrimit, çështjet janë shpërndarë me short manual, në rastet në të cilat prokurori i çeshtjes nuk ushtron detyrën në këtë institucion. Sipas grafikut të gadishmerisë çështjet penale me veprime të ngutshme, jashtë orarit zyrtar dhe me të arrestuar janë trajtuar nga prokurori i gatshëm.

Theksojmë se zëvendësimet e prokurorëve, gjatë këtij viti, kanë qënë të shumta, për shkaqet që përmendëm më sipër.

Referuar të dhënave që do t'ju paraqesim dhe analizojmë në këtë raport vjetor, evidentohet se gjatë vitit 2021, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë, ka përballuar një ngarkesë pak më të madhe se viti i kaluar, por duke patur parasysh që gjatë vitit 2020 për shkak të pandemisë së shkaktuar nga covid-19 është ulur disi numri i veprave penale, kjo edhe për shkak të karantinës.

Ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale kanë bërë që puna administrative e prokurorit të shkallës së parë këtë vit të shtohet ndjeshëm, kryesisht në Zyrën e Regjistrit.

## 2.2-TË DHËNA NË LIDHJE ME NJOFTIMET PËR VEPRAT PENALE

Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë, për vitin 2021, janë regjistruar gjithësej 1735 kallëzime penale.

Krahasuar me një vit me parë, janë regjistruar 240 kallezime penale më shumë.




Referuar grafikut të mësipërm, vihet re që: 89.34% e kallëzimeve të regjistruara në vitin 2021 janë referuar nga Policia e Shtetit; 8.18% e kallëzimeve janë bërë nga shtetasit; 0.29% e kallëzimeve penale janë bërë nga nëpunesit publik; 1.90 % e kallëzime janë bërë nga policitë e tjera dhe 0.29% çështje janë nisur kryesisht nga prokurori.



Referuar grafikut të mësipërm, vihet re se: 30.28 % e kallëzimeve penale të regjistruara në vitin 2021 janë vepra penale që i përkasin KREUT te III -të të Kodit Penal, "Veprat penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike", 46.7% janë vepra penal që i përkasin Kreut të VIII- "Vepra penale kundër autoritetit të shtetit", 18.64 % vepra penale që i përkasin Kreut II- "Vepra penale kundër personit", ndërsa pjesa e tjetër është e shpërndarë në krerët e tjerë sipas grafikut të mësipërm.

## 2.3-TREGUESIT KRYESORË TË PUNËS SË PROKURORISË

Në vitin 2021 janë regjistruar gjithsej 1220 procedime penale (rezultojnë të hetuar 1213 procedime penale për shkak të bashkimeve dhe ndarjeve të procedimeve penale), ndër të cilat 14 procedim penale kanë ardhur me transferim nga prokuroritë e tjera, ndërkohë që në vitin 2020 janë regjistruar gjithsej 1266 procedime penale, ndër të cilat 11 procedim penale kanë ardhur me transferim nga prokuroritë e tjera. (pasqyruar në grafikun më poshtë)

Theksojmë se në vitin 2021 janë regjistruar 46 procedime penale më pak se në vitin 2020.



Në vitin 2020 në total janë hetuar 1256 procedime penale, ndërsa në vitin 2021 janë hetuar në total 1626 procedime penale.. (pasqyruar në grafikun më poshtë)

Krahasuar me një vit me parë, këtë vit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë ka hetuar 370 procedime penale më shumë.






Grafiku I mësipërm jep të dhënat mbi procedimet e regjistruara në vitin 2021, duke përfshirë të gjitha bashkime apo ndarjet e procedimeve penale 2021. Konkretisht janë vendosur 18 bashkime dhe 11 ndarje procedimesh.

Referuar grafikut të mësipërm, vihet re që procedimet penale të reja në 2021, përbëjnë 74.6% të totalit të procedimeve penale të hetuara për vitin 2021, procedimet e mbartuara në vitin 2021 zënë 25.3%. Në kuadrin e procedimeve penale të hetuara gjatë vitit 2021, është ushtruar ndjekja penale në total ndaj 776 personave, nga këta 259 nga procedimet e mbartura nga ku rezultojnë 85 përsona në hetim dhe 174 përsona të pandehur **dhe** 517 përsona të hetuar rrjedhin nga procedime të regjistruara në vitin 2021, nga ku 174 përsona rezultojnë në hetim dhe 343 përsona të marrë si të pandehur.

### 2.3.1-ÇËSHTJE TË MOSFILLUARA

Në vitin 2021 është vendosur mosfillimi I procedimit penal për gjithsej 485 kallëzime penale, ndërkohë që në vitin 2020 eshte vendosur mosfillimi per gjithsej 553 kallezime penale, pra me një diferencë prej 68 mosfillime më pak për vitin 2021.

Ulja e numrit të kallezimeve penale për të cilat është disponuar me vendim mosfillimi në krahasim me një vit me parë ka ardhur dhe si pasojë e rritjes së cilësisë së materialeve referuese si dhe veprimeve verifikuese të kryera nga prokurorët dhe opgj-të e prokurorisë ku kanë rezultuar element të veprave penale të cilat kanë kërkuar veprime hetimore dhe rrjedhimisht afat më të gjatë verifikimi.



- Per 485 kallëzime penale është disponuar me vendim mosfillimi për faktin se është referuar për vepër penale konkrete dhe ka rezultuar se nuk ka patur elemente të veprave penale, si dhe në rastet e veprave penale që ndiqen me ankim direkt në gjykatë nga të demtuarit akuzues.

Janë ankimuar 26 vendime mosfillimi, ku për 23 vendime gjykata ka vendosur lënien në fuqi të tyre.

Nga ana e Gjykatës janë shfuqizuar 3 vendime mosfillimi, të cilat janë regjistruar duke marrë numër procedimi, nga këto tre procedime : për 1 procedim është vendosur pezullimi I hetimeve, për 1 procedim është bërë kërkesë në gjykatë për pushim dhe 1 procedim vijon të jetë në hetim.

## 2.3.2-PROCEDIMET PENALE TË BASHKUARA

Në vitin 2021, janë bashkuar me procedime të tjera, gjithsej 18 procedime penale.




Nga 1220 procedime penale të regjistruara në vitin 2021 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës se Parë Lezhë, 18 procedime penale të bashkuara përbëjnë vetëm 1.44 % të totalit të ngarkesës, 11 procedime janë ndarë që përbëjnë 1% të totalit të ngarkesës. Ngelen në hetim si rezultat I bashkimeve dhe ndarjeve të procedimeve 1213 procedime penale të regjistraura në vitin 2021.

Në vitin 2021 janë hetuar gjithsej 1626 procedime penale, duke përfshirë edhe procedimet e mbartura; Nga 1626 procedime penale:

- 24 procedime penale janë transferuar dhe
- 241 procedime penale janë pushuar/dërguar për pushim,
- 292 procedime penale janë pezulluar,
- 423 procedime penale janë dërguar për gjykim (janë gjykuar gjithsej 418 cështje, mbeten në gjykim 105 cështje, ku 100 cështje ishin të mbartura në gjykim nga viti 2020),
- 646 procedime mbeten hë hetim duke kaluar të mbartura për vitin 2022.

## 2.3.3-PROCEDIME PENALE TË TRANSFERUARA

Gjatë vitit 2021 janë transferuar gjithsej 24 procedime penale, me 4 persona nën hetim, ndër të cilët 2 përsona me masë sigurimi arrest në burg. Transferimet janë bërë kryesisht për kompetence territoriale.




Nga 1220 procedimet penale të regjistruara për vitin 2021, 24 procedime penale të transferuara përbëjnë 1.93% e totalit te procedimeve të hetuara ne vitin 2021.

## 2.3.4-PROCEDIME PENALE TË PUSHUARA

Gjatë vitit 2021 nga ana e prokurorëve është dalë me vendim pushimi apo kërkesë për pushimin e cështjes penale drejtuar gjyqtarit të seancës paraprake për gjithsej 241 procedime penale ku për 77 procedime është dalë me vendim pushimi dhe me kërkesë për pushim procedimi penal drejtuar

gjykatës për 164 procedime penale. 194 procedime janë pushuar për mungesë fakti, dhe 47 procedime penale jane pushuar per shkaqe te tjera procedurale.

Grafiku më poshtë paraqet %-en e procedimeve të pushuar në raport me totalin e procedimeve të hetuar në vitin 2021. Ku rezulton se nga 1626 procedime penale të hetuar në vitin 2021, janë pushuar 12.91 % e tyre.




Gjatë vitit 2020 nga ana e prokuroreve është dalë me vendim pushimi apo kërkesë për pushimin e çështjes penale drejtuar gjyqtarit të seances paraprake për gjithsej 247 procedime penale, nga këto:

- 124 procedime të pushuara për krime me kërkesa për pushim në gjykatë dhe
- 123 procedime janë pushuar me vendim të prokurorit pasi janë kundravajtje penale.

Nga këto rezultojnë:

- 217 procedime janë pushuar për mungesë fakti, dhe
- 30 procedime penale jane pushuar per shkaqe te tjera procedurale.

Ndër shkaqet e tjera me kryesoret janë për mungesë të elementeve të veprës penale dhe heqjet dorë nga ankimi i të dëmtuarit, për veprat penale që ndiqen me ankim.




Referuar grafikut të mësiperm, vihet re që 80.5 % e procedimeve penale të pushuara. janë pushuar për mungesë fakti, dhe 19.5 % e tyre për mungesë prove dhe shkaqe të tjera.



Veprat penale te Kreut VIII-te “Vepra kundër autoritetit të shtetit ” zënë 50.21 % te procedimeve penale te pushuara, te Kreut III – “ Vepra penale kundër pasurisë dhe ekonomisë” zënë 25.73 % të procedimeve të pushuara, te Kreut II - “Vepra penale kundër personit” 18.67 % të pushuara.

Gjithsej 77 procedime penale janë pushuar nga prokurori pasi përbëjnë kundravajtje penale.

Në total këtë vit janë dërguar në gjykatë 164 kërkesa për pushimin e çështjes penale.

Ndër procedimet penale të pushuara, me vendim prokurori apo nga gjyqtari i hetimeve paraprake bazuar në kërkesën për pushimin e ceshtjes penale të paraqitur nga prokurori:

- Është pushuar ndjekja penale për 69 persona në hetim.
- Për 44 prej ketyre personave në hetim, janë pushuar hetimet për mungesë fakti;
- Për 9 persona nën hetim janë pushuar hetime për mungesë prove;
- Për 16 persona nën hetim pushimi është bërë për shkaqe të tjera.

Sipas grafikut më poshtë



## 2.3.5-ÇËSHTJE TË PEZULLUARA

Gjatë vitit 2021, janë pezulluar gjithsej 292 procedime penale. Të gjitha këto procedime penale janë pezulluar për shkak se nuk është bërë e mundur të zbulohet autori i vepres penale, nga këto procedime 56 procedime penale vijnë të mbartura nga vitet e mëparshme dhe 236 janë procedime të regjistruar në vitin 2021.

Gjatë vitit 2020, janë pezulluar gjithsej 255 procedime penale. Të gjitha këto procedime penale janë pezulluar për shkak se nuk është bërë e mundur të zbulohet autori i vepres penale.




Janë pezulluar pasi nuk është bërë I mundur identifikimi I autorit/autorëve të veprës penale, 16 % e procedimeve penale të regjistruara në 2021.



Referuar statistikave, rezulton se pjesa më e madhe e procedimeve penale të pezulluara, edhe këtë vit, lidhet me veprat penale kundër pasurisë, pra veprat penale të Kreut III, “Vepra penale kundër pasurisë dhe ekonomisë”që zënë 82% të procedimeve të pezulluara, dhe kryesisht me veprën penale të vjedhjes ku pjesën kryesore e zënë vjedhjet e banesave, e ndjekur nga veprat penale të Kreut VIII- “Vepra penale kundër Autoritetit të shtetit” 13%, të Kreut IX- veprat penale të Kreut II- “Vepra penale kundër personit” 3 %.

Është e domosdoshme që për zbulimin e autorëve të këtyre veprave penale, që përbën një shqetësim real për komunitetin që përfshin Qarku i Lezhës, të gjitha strukturat policore, si ato për parandalimin dhe për hetimin e ketij krimi të organizojnë një punë të mirëfilltë profesionale, ku krahas përdorimit të mjeteve klasike për sigurimin e provave të përdorin edhe mjete të posaçme për kërkimin e tyre.

Nga prokurorët është kërkuar në vazhdimësi, që të tregohet vëmendja e duhur me qellim që pezullimi i procedimit penal të vendosej pas kryerjes nga policia gjyqësore të të gjithë veprimeve hetimore paraprake të mundshme.

Pavaresisht nga sa më siper, është me vënd të kërkohet një vemendje më e madhe nga oficerët e policisë gjyqësore, të shërbimeve dhe seksionit, gjatë kryerjes së veprimeve të papërseritshme të hetimit paraprak, si kqyrja e vendit të ngjarjes, evidentimi i të gjitha gjurmëve dhe sendeve të gjetura aty, marrja e provave materiale, me qëllim që numri procedimeve penale të kesaj natyre (pezullimi për këtë shkak), të vijë duke u zvogëluar.

## 2.3.6-PROCEDIMET PENALE TË DËRGUARA PËR GJYKIM

Në vitin 2021 janë dërguar për gjykim gjithsej 423 procedime penale me 500 presona të pandehur, ndër të cilët 87 të pandehur me masë sigurimi arrest në burg. Rezulton se 21 % e procedimeve penale të hetuara në vitin 2021 janë dërguar për gjykim. Sipas të dhënave, kemi një ulje në përqindje në krahasim me vitin 2020, edhe pse është numër më I madh procedimesh që është dërguar për gjykim, kjo vjen si rrjedhojë pasi në vitin 2021 kemi numër më të lartë të procedimeve në hetim.

Në vitin 2020, janë dërguar për gjykim gjithsej 373 procedime penale, me 408 persona të pandehur, ndër të cilët 38 të pandehur me masë sigurimi arrest në burg. Rezulton se 29.6 % e procedimeve penale të hetuara në vitin 2020 janë dërguar për gjykim.







Përsa i përket procedimeve penale të dërguara për gjykim në vitin 2021, rreth 65% e zënë procedimet penale që përfshihen në Kreun VIII- "Vepra penal kundër autoritetit të shtetit", Kreu III- "Vepra penale kundër pasurisë dhe ekonominsë" 13%, Kreu II- "Vepra penale kundër personit " 17 %, Kreu IX- "Vepra penale kundër drejtësisë" 3 %, ndërsa pjesën tjetër të çështjeve të dërguara në gjyq e përbëjnë çështjet e krerëve të tjerë. Persa i perket personave ne cilesine e te pandehurit cilet jane deguar ne gjykim, 87 prej tyre kane qene me mase sigurimi arrest ne burg. Ndërsa pjesa tjetër me masa sigurimi të tjera dhe në gjëndje të lirë.

Përsa i përket kërkesave të dërguara në gjykatë janë sipas grafikut më poshtë;

***KËRKESA / PROKURORIA***




***VENDIME/GJYKATA***




Në total në vitin 2021 janë bërë 423 kërkesa për dërgimin në gjyq+urdhëra penale+ marrëveshje për gjykim.

Grafiku i mëposhtëm tregon në përqindje statusin e procedimeve penale te hetuara ne vitin 2021.




Në total në vitin 2020 janë bërë 520 kërkesa për dërgimin në gjyq+urdhëra penale+ marrëveshje për gjykim.

Përsa I përket procedimeve penale të vitit 2021, rezultojnë të jenë përfunduar në total 980 procedime penale ( 17% pushuar, 21% pezulluar, 2% transferuar, 30% dërguar për gjykim dhe 1% bashkuar)

E thënë ndryshe janë përfunduar 60% e procedimeve penale të hetuara në vitin 2021, dhe janë mbartur 40%.



Sa më sipër, për një periudhë njëvjecare, (duke përfshirë të gjitha vendimmarrjet mosfillimet, pushimet, pezullimet, transferimet, dërguar gjyqit ), janë përfunduar gjithsej 1465 çështje penale.

Në vitin 2022, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë mbart në hetim 646 procedime penale, e thënë ndryshe 40 % e procedimeve penale.

Përsa i përket vitit 2020 rezultojnë të jenë perfunduar nga nje total prej 875 procedime penale (pushimet 20%, pezullimet 20%, transferimet 2%, derguar gjyqit 27 %, dhe bashkuar 2 %). Pra 70% e procedimeve të hetuar në vitin 2020 janë përfunduar brënda viti.

## 2.3.7-TREGUESIT E ARRESTIMEVE NË FLAGRANCE DHE NDALIMEVE

Për vitin 2021, treguesit e arrestimeve në flagrancë dhe ndalimeve, të kryer ndaj shtetasve të dyshuar për kryerjen e veprave të ndryshme penale, paraqiten si më poshte:

Janë arrestuar në flagrancë nga policia gjyqësore 350 shtetas.
Janë ndaluar nga policia gjyqësore 7 shtetas si dhe 2 shtetas nga prokurori.

Është kërkuar në gjykatë vleresimi i arrestimit në flagrancë apo ndalimit për 357 përsona. Gjykata ka vlerësuar të ligjshëm arrestimin/ndalimin për 353 përsona.

Për 33 përsona për të cilët është kërkuar nga ana prokurorisë masa e sigurimit "Arrest në burg", gjykata shkallës së parë ka dhënë për 31 përsona masën e sigurimt "Arrest në shptëpi" , për 2 përsona ka vendosur masën ""Garanci pasurore", nga prokuroria janë ushtruar 33 ankime, gjykata e apelit ka vendosur pranimin e ankimit për 13 shtetas për të cilët është vendosur masa e sigurimit "Arrest në burg"parashikuar nga neni 238 I K Pr.Penale.

Janë kërkuar nga ana e prokurorëve për 5 raste/ përsona, caktimi i masës së sigurimit arrest me burg në mungese dhe nga ana e Gjykatës është vendosur kjo masë për 4 raste.

Nga ana e prokurorëve është treguar kujdes i veçantë të mos caktohet masa e sigurimit "arrest në burg" pa patur një dyshim të arsyeshëm të bazuar prova dhe nga ana tjetër dhe të mos merren përsona të pandehur pa patur një bazë të mjaftueshme të të dhënave që do të siguronin mbrojtjen e akuzës në gjykim.

Për 36 persona të arrestur në flagrancë, në përfundim të hetimeve paraprake është kërkuar pushimi I hetimeve nga ana prokurorit ku një procedim është kthyer nga gjykata për vazhdimin e hetimeve për një afat 2 mujor, për një të pandehur është kërkuar pushimi I cështjes dhe caktim mase mjekësore e cila është pranuar nga gjykata.

Për një shtetas të arrestuar është kërkuar nga ana e prokurorit dërgimi i cështjes në gjyq, gjykata ka dhënë pafajësi kundër vendimit të gjykatës ka ushtruar ankim prokurori I cështjes.

Veprat penale për të cilat është vendosur arrestimi në flagrancë kanë qënë veprat penale të Kreut të VIII-të "Vepra penale kundër autoritetit të shtetit", veprat penale të Kreut të III-të, "Vepra penale në sferën ekonomike" si dhe ato të kreut të II-të, "Vepra penale kundër personit":

***PROKURORIA***




***GJYKATA***



Të dhënat për vitin paraardhës, viti 2020:

Janë arrestuar në flagrancë nga policia gjyqësore 224 shtetas.
Janë ndaluar nga policia gjyqësore 7 shtetas.

Është kërkuar në gjykatë vlerësimi i arrestimit në flagrancë apo ndalimit për 231 përsona. Gjykata ka vlerësuar të ligjshëm arrestimin/ndalimin për 230 përsona dhe të paligjshëm për 3 përsona. Në lidhje me vleftësimin e arrestimit të paligjshëm, paligjshmeria sipas Gjykatës ka konsistuar në intepretimin e kohës së kapjes së personit, me procesverbalin e arrestimit në flagrancë.

Janë kërkuar nga ana e prokurorëve për 4 raste, përsona, caktimi i masës së sigurimit arrest me burg në mungese dhe nga ana e Gjykatës është vendosur kjo masë për 4 raste.

## 2.3.8-TË DHËNA PËR FAZËN E E EKZEKUTIMIT

Gjatë vitit 2021, janë nxjerrë gjithsej 339 urdhëra ekzekutimi, në krahasim me 331 urdhëra ekzekutimi të nxjerra në vitin 2020. Pra janë nxjerrë 8 urdhëra ekzekutimi më shumë se në vitin 2020. Ndërsa në vitin 2019 janë nxjerrë 356 urdhëra ekzekutimi. Rënia e numrit të ekzekutimeve nga viti 2019 vjen si rezultat I transferimit të të dënuarve nga I.E.V.P. Shënkollë në I.E.V.P. Reç, si dhe për shkak të nënies së nr. të procedimeve penale si pasojë e pandemisë së shkaktuar nga Covid-19.

Rritja e lehtë nga viti 2020 ka të bëjë me numrin më të madh të cështjeve të dërguar për gjykim (2020-373 cështje për gjykim, viti 2021- 423 cështje të dërguara për gjykim)

Nga 339 urdhëra ekzekutimi të viti 2021, kanë qënë me burgim 328 urdhëra ekzekutimi, me gjobë kanë qenë 11 urdhëra ekzekutimi. Nga këto 212 pezullim ekzekutimi, 64 punë në interes publik dhe 2 lirim para kohe me kusht.




## 2.4-KRIMINALITETI SIPAS SHTRIRJES TERRITORIALE TË NJËSIVE ADMINISTRATIVE NË KOMPETENCË TË PROKURORISË.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë e shtrin juridiksionin e saj në 2 Bashki; Bashkia Lezhë dhe Bashkia Mirditë.

Duke qenë se Bashkia Lezhë ka shtrirjen më të madhe territoriale, popullsinë më të madhe, për rrjedhojë dhe numri i kriminalitetit është më i madh në krahasim me Bashkinë Mirditë

# III-TREGUESIT STATISTIKORË 2 VJECARE TË VEPRAVE PENALE

## 3.1-KRIMINALITETI SIPAS PESHËS/PËRHAPJES SË VEPRAVE PENALE DHE TENDENCAVE TË TYRE DHE KRIMINALITETI SIPAS STRUKTURËS SË KODIT PENAL (KRIME - KUNDËRVAJTJE).

Lidhur me gjëndjen e kriminalitetit gjatë vitit 2021 ( theksojmë që këto të dhëna janë përpunuar duke zbritur procedimet penale të bashkuara), veprat penale të cilat zënë numrin me të madh të procedimeve penale të hetuara janë veprat penale të parashikuara nga Kreu II-te, Kreu III-të dhe Kreu VIII-te i K.Penal.

Konkretisht:
VITI 2021

Kreu I- 0 procedime.

Kreu II -te, gjithsej 227 procedime penale.

Kreu III-te, gjithsej 574 procedime penale.

Kreu IV-te, gjithsej 35 procedime penale.

Kreu V- 0 procedime.

Kreu VI – 0 procedime.

Kreu VII – 1 procedime.

Kreu VIII-te, gjithsej 750 procedime penale.

Kreu IX-te, gjithsej 37 procedime penale.

Kreu X-te, gjithsej 2 procedime penale.

Kreu XI – 0 procedime penale.



**VITI 2020**

Kreu I- 0 procedime.

Kreu II -te, gjithsej 140 procedime penale.

Kreu III-te, gjithsej 484 procedime penale.

Kreu IV-te, gjithsej 27 procedime penale.

Kreu V- 0 procedime.

Kreu VI – 0 procedime.

Kreu VII – 1 procedime.

Kreu VIII-te, gjithsej 573 procedime penale.

Kreu IX-te, gjithsej 39 procedime penale.

Kreu X-te, gjithsej 2 procedime penale.

Kreu XI – 0 procedime penale.




Sipas grafikëve të mësimpërm rezulton se krahasuar me vitin 2020, në vitin 2021 kemi një rritje të nr. të cështjeve të regjistruara për krerët II, III, IV dhe VIII dhe ulje në kreun IX të strukturës së Kodit Penal.

Përsa i përket procedimeve të regjistruar në vitin 2021 të dhënat vijojnë si më poshtë (këto të dhëna janë përpunuar duke llogaritur momentin e regjistrimit ku, më pas, një pjesë e tyre rezulton të jenë bashkuar ose ndarë):

Grafiku i mëposhtëm tregon kriminalitetin sipas strukturës së Kodit Penal, të procedimeve penale të hetuara gjatë vitit 2021, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë.




Përsa i përket çështjeve të hetuara për vitin 2021 nga Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë rezulton të jenë të ndara ne 84 % krime dhe 16 % kundravajtje penale.

Ndërkohë që krahasuar më vitin 2020 kishim një ndarje krime dhe kundravajtje në raportin 81 % Krime dhe 19% kundravajtje (1028 krime dhe 238 kundravajtje)

- *Shënim :* ***Bashkëlidhur këtij raporti, gjenden tabelat e treguesve statistikorë të veprave penale sipas strukturës së Kodit Penal për vitet 2020, 2021.***

# IV-ANALIZA E TREGUESVE TË EFEKTIVITETIT TË PUNËS SË PROKURORISË

## 4.1-TREGUESI I EFEKTIVITETIT NË GJYKIMIN DHE NË DENIMIN E TË PANDEHURVE

Në lidhje me cështjet penale të derguara për gjykim gjatë vitit 2021, ka përfunduar gjykimi për 418 procedime penale, me 449 të pandehur, prej të cilëve 31 persona të arrestuar. Është kërkuar pushimi i çështje për 8 procedime me 8 të pandehur.

Në lidhje me cështjet penale të dërguara për gjykim gjatë vitit 2020, ka përfunduar gjykimi për 272 procedime penale, me 305 të pandehur, prej të cilëve 33 persona te arrestuar. persona të arrestuar. Është kërkuar pushimi i çështje për 4 procedime me 4 të pandehur.

Për fazën e gjykimit i është kushtuar rëndësi sigurimit të provave të mjaftueshme për të vërtetuar fajësine e të pandehurve, si dhe diferencimit të llojit e masës së dënimit, në varësi të veprës penale të kryer. Për veprat penale me rrezikshmëri të theksuar shoqërore si ato kundër jetës së përsonit, vjedhjet e cilësuara, veprat penale të mbajtjes apo shitjes së substancave narkotike, dhunës në familje etj, kërkesat për llojin dhe masën e dënimit kanë qenë të larta.

## 4.2-TË DHËNA PËR GJYKIMET E POSAÇME

- ✓ Për vitin 2021 për 413 çështje me 438 të pandehur është aplikuar "Gjykim I shkurtuar"
- ✓ Për 22 procedime me 26 të pandehur është aplikuar "gjykimi i zakonshëm"

Grafiku i mëposhtem tregon në % gjykimet e posaçme



Ndërsa për vitin 2020

- ✓ Për 304 çështje me 349 të pandehur është aplikuar ”gjykimi i shkurtuar”.
- ✓ Për 5 procedim me 5 të pandehur është aplikuar “ gjykimi i drejtpërdrejtë

## 4.3-TË DHËNA MBI LLOJET DHE MASAT E DËNIMEVE

Grafiku i mëposhtëm jep një pasqyrë të llojeve dhe masave të denimeve të kërkuara nga Prokurori për vitin 2021




Grafiku i mëposhtëm jep një pasqyre të llojeve dhe masave të dënimeve të dhëna nga Gjykata për vitin 2021




Këtë vit janë dhënë gjithsej 17 pafajësi, ku 4 pafajësi janë kërkuar nga vetë prokurori, kundrejt 15 pafajësive të dhëna nga Gjykata në vitin 2020, me 0 pafajësi të kërkuar nga prokurori. Pra kemi një rënie të numrit të pafajësive të dhëna nga Gjykata, për vitin 2021.

Gjatë vitit 2021 prokurorët kanë apeluar vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë, lidhur me vendimin përfundimtar për shkaqe të ndryshme, si pafajësi apo llojet e masat e dënimit të gjykuara

si të papërshtatshme nga prokurori. Mbeten në gjykim per vitin ne vazhdim 105 procedime penale, me 165 te pandehur nga të cilët 58 me masë sigurimi “Arrest në Burg”.

Kemi një ulje të procedimeve të mbartuara në gjykim në krahasim me një vit më parë ku mbetën të mbartura në gjykim 158 procedime penale, me 182 të pandehur nga të cilët 15 ishin me masë sigurimi “Arrest në Burg.

## 4.4-TENDENCA E KRIMINALITETIT SIPAS MOSHËS, VENDBANIMIT, ARSIMIT DHE SEKSIT

Në procedimet penale të hetuara gjatë vitit 2021 janë hetuar dhe marrë të pandehur 776 përsona.

Përsa i perket të pandehurve, gjatë vitit **2021**, janë gjykuar gjithsej gjithsenj 449 persona, ndër të cilët 444 meshkuj dhe 5 femra.

Në lidhje me procedimet penale me persona të mitur të përfshirë, rezulton se janë hetuar gjatë vitit 2021, 63 referime penale, me persona të mitur, si të mitur në konflikt me ligjin 60 procedime penale, dhe të mitur viktima 4 procedime penale (*një procedim penal ka të mitur autor dhe të mitur viktimë*). Nga këto në 13 raste është vendosur mosfillimi i procedimit penal. 13 procedime janë pushuar pasi është marrë masa e shmangies nga përgjegjësia penale për të miturit. Ndërsa në 1 rast procedimi është pushuar për shkaqe të tjera ligjore.

Janë dërguar për gjykim 14 cështje me të mitur në konflikt me ligjin, me 9 përsona të pandehur të mitur, 13 (trembëdhjetë) cështje për veprën penale të parashikuar nga neni 291, 7 të mitur në grupmoshën 16-18 vjec, dhe 2 të grupmoshës 14-16 vjec. Një i mitur në konflikt me ligjin është dërguar për gjykim për veprën penale të parashikuar nga neni 101/2 i K.Penal me masë sigurimi «Arrest në burg », i grupmoshës 16-18 vjec.

Pjesa më e madhe e të miturve në konflikt me ligjin (kemi parasyshë të gjithë materialet referuese me të mitur) janë të moshës 16-18 vjec (20 persona), ndërsa pjesa tjetër janë të grupmoshës 14-16 vjec (3 persona). Në lidhje me gjininë 99 % e të miturve në konflikt me ligjin janë meshkuj. Nga ana tjetër në lidhje me viktimat e mitura 90 % e tyre janë femra dhe vetëm 10 % janë meshkuj.

Nga nr. total i të pandehurve/dënuarve janë me arsim 9 vjeçar 326 persona, me arsim të mesëm 125 persona dhe me arsim të lartë 18 persona. Nga personat e marrë të pandehur/dënuar për vitin 2021 janë 144 persona banues në qytet dhe 309 persona banues në fshat. Nga të pandehurit 8 persona kanë qënë të dënuar më parë për të njëjtën vepër, 5 persona të dënuar për vepra të tjera dhe 436 persona të padënuar më parë.

Në procedimet penale të hetuara gjatë vitit **2020** janë hetuar dhe marrë të pandehur 645 persona.

Përsa i përket të pandehurve, gjatë vitit 2020, janë gjykuar gjithsen 305 persona, ndër të cilët 298 meshkuj dhe 7 femra.

Nga nr. total i të pandehurve/dënuarve janë me arsim 9 vjeçar, 191 persona, me arsim te mesem 79 persona dhe me arsim te larte 19 persona. Nga personat e marrë të pandehur/dënuar për vitin 2020 janë 74 persona jane banues në qytet dhe 230 persona banues në fshat. Nga te pandehurit 5 persona kane qënë të dënuar më pare për të njëjtën vepër, 9 persona të dënuar për vepra të tjera dhe 279 persona te padënuar me parë.

# V-TË DHËNA LIDHUR ME MARRËDHËNIET JURIDIKSIONALE ME AUTORITETET E HUAJA

Përsa i përket marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja, për vitin 2021 të dhënat paraqiten sa vijon:

- Janë bërë 2 kërkesa për ekstradim për jashtë shtetit dhe nga jashtë shtetit.
- Letërporosi nga jashte shtetit kanë mbërritur në total 28 kërkesa, si për shembull, njoftim aktesh, marje në pyetje, njoftim date seance gjyqësore etj.
- Gjithashtu janë dërguar 3 letërporosi per jashte shtetit.
- Janë lëshuar urdhëra për kerkim ndërkombetar dhe janë hequr nga kërkimi ndërkombëtar.

Përsa i përket marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja, për vitin 2020 të dhënat paraqiten sa vijon:

- Janë bërë 9 kërkesa për ekstradim për jashtë shtetit dhe nga jashtë shtetit.
- Letërporosi nga jashtë shtetit kanë mbërritur në total 25 kërkesa, si për shembull, njoftim aktesh, marje në pyetje, njoftim date seance gjyqësore etj.
- Gjithashtu janë dërguar 4 letërporosi për jashtë shtetit.
- Janë lëshuar urdhëra për kërkim ndërkombetar dhe janë hequr nga kërkimi ndërkombetar.

# VI-TË DHËNA PËR NGARKESËN E PUNËS SË PROKUROREVE DHE OFICERËVE TË POLICISË GJYQËSORE

Ngarkesa në punë e prokurorëve përsa i përket cëshjeve penale në hetim dhe mënyrën e përfundimit të tyre për vitin 2021, ( 485 mosfillime dhe 1626 procedime penale) paraqiten si më poshtë në tabelen e detajuar (prokurori/mosfillime/procedime në hetim në vitin 2021, ku bëjnë pjesë të regjistruara në vitin 2021, të mbartura, të rifilluara/shfuqizuara etj, dhe mënyra e përfundimit pushuar/pezulluar/transferuar/dërguar gjyqit/procedime të bashkuara me procedime të tjera dhe procedimet e mbartura në hetim për vitin 2022).

Grafiku i mëposhtëm tregon në % ngarkesën e prokurorëve për vitin 2021.



Grafiku i mëposhtëm tregon në % procedimet e mbartura për çdo prokuror:




Nga 1626 procedime të hetuara gjithsej në vitin 2021, 413 kanë ardhur të mbartura nga vitet e mëparshme të ndara sipas prokurorëve sipas grafikut të mësipërm.

Nga 413 procedimet e mbartura rezultojnë se:

- 124 procedime janë dërguar për gjykim
- 96 procedime janë pushuar
- 56 procedime janë pezulluar
- 6 procedime janë transferuar
- 131 procedime janë në hetim

Për cështjet e gjykuara në vitin 2021 rezultojnë të dhënat si më poshtë :

Nga ana e prokurorisë është kërkuar deklarimi fajtor për 445 të pandehur për të cilët për 422 të pandehur ka vendim fajësie nga gjykata dhe për 17 pandehur gjykata ka dhënë pafajësi ku për 4 të pandehur është kërkuar pafajësi nga vetë prokurori.

Grafiku i mëposhtëm tregon në % mosfillimet për çdo prokuror.




Në vitin **2020** ngarkesa në punë e prokurorëve përsa i përket cështjeve penale në hetim dhe mënyrën e përfundimit të tyre ishte; 553 mosfillime dhe 1266 procedime penale, ku bejne pjesë të regjistruara në vitin 2020, të mbartura, të rifilluara/shfuqizuara etj, ku nga këto 364 procedime penale ishin të mbartuara nga vitet e mëparshme.

Duhet theksuar edhe një herë se mungesa e prokurorëve ka sjellë dhe një rritje të numrit të çështjeve që mbarten për vitin pasardhës.

Në organikën e Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë janë gjithsenj 6 oficer të policisë gjyqësore te Seksionit të Prokurorisë;

1. Artan Uka ( i ngarkuar edhe në seksionin e ekzekutimeve të vendimeve penale).
2. Alfred Gjoka.
3. Mimoza Dushkaj.
4. Edison Dullaj.
5. Rita Ndoka.
6. Lulash Tusha.

Gjatë vitit 2021, treguesit e përgjithshëm të volumit të punës së kryer nga Oficerët e Policisë Gjyqësore, të seksionit të prokurorisë, për procedimet e hetuara në vitin 2021 paraqiten si më poshtë :




Nga të dhënat e pasqyruara në grafik rezulton se për rreth 72 % të procedimeve të hetuara të për vitin 2021 janë hetuar nga oficerët e policisë gjyqësore të seksionit të prokurorisë, dhe rreth 28 % e procedimeve të tjera të hetuara në vitin 2021 janë hetuar nga oficerët e policisë gjyqësore të policisë së shtetit.

Gjatë viti 2020 rezulton se për rreth 52 % të procedimeve të hetuara janë hetuar nga oficerët e policisë gjyqësore të seksionit të prokurorisë, dhe rreth 48 % e procedimeve të tjera.

Pra krahasuar me vitin 2020 kemi një rritje të hetimeve të kryera nga oficerët e seksionit të prokurorisë, për vitin 2021.

# VII-INFORMACION MBI ADMINISTRIMIN E PROKURORISË

Për të siguruar mbarëvajtjen e punës në prokurori përmes ushtrimeve të funksionit nga ana e drejtuesit të prokurorisë janë nxjerrë disa urdhëra dhe udhëzime të përgjithshmë dhe për çështje konkrete.

Konkretisht në vijim të zbatimit të Udhëzimit të Përgjithshëm Nr.12, datë 20.07.2020, «Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë, në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm», nga Drejtuesi i Prokurorisë është nxjerrë udhëzimi i përgjithshëm me nr.1, datë 12.10.2021 «Për rregullimin e marrëdhënieve mes drejtuesit të prokurorisë dhe prokurorëve në lidhje me informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë». Në vijim është bërë shpërndarja dhe njohja me urdhërin e prokurorëve të Prokurorisë Lezhë dhe ka filluar zbatimi në praktikë i tij, duke nxjerrë udhëzime jo të detyrueshme dhe kërkesa për informacion drejtuar prokurorëve në lidhje me çështje konkrete apo procedime penale të caktuara.

Gjatë vitit 2021, rregjistri për dokumentimin e levizjes së materialeve, në zbatim të udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm, është mbajtur nga sekretarja pranë drejtuesit të prokurorisë, në të cilin janë shënuar të gjitha kërkesat, informacionet, udhëzimet e përgjithshme dhe të posaçme, dosjet e përfunduara për gjykim, të pushuara, moskompetencë, të pezulluara, të mosfilluara, etj

Gjithashtu, janë udhëzuar prokurorët në kontrollin periodik dhe efektiv të punës së oficerëve të policisë gjyqësore në lidhje me dosjet e deleguara prej tyre. Me qëllim kryerjen e hetimeve të plota dhe cilësore dhe shmangien e vonesave dhe zvarritjeve në përfundimin e hetimeve.

Prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore u është kërkuar të angazhohen drejtpërdrejt në rritjen e tyre profesionale, në plotësimin e formularëve për trajnime dhe seminare dhe për pjesëmarrjen fizike të tyre ose onlinë në trajnimet e realizuara nga Prokuroria e Përgjithshme, Shkolla e Magjistraturës, Ministria e Drejtësisë dhe shoqatat e organizatat vendase dhe të huaja duke respektuar edhe fushat specifike ku ata kanë më shumë nevojë.

Nga ana tjetër, janë nxjerrë urdhëra dhe udhëzime konkrete për çështje të caktuara nga Drejtuesi i Prokurorisë dhe janë kërkuar informacione në lidhje me çështje konkrete objekt i rekomandimeve të KM. Në rastet kur është vlerësuar se këto detyra dhe objektiva në procedimet penale konkrete janë komplekse, ka zvarritje apo vonesa dhe nuk janë përfunduar me përparësi nga ana e prokurorëve, si dhe nuk janë kryer veprimet hetimore me përparësi nga ana e oficerëve të çështjeve konkrete është udhëzuar dhe rekomanduar kryerja me prioritet e detyrave të lëna.

Në zbatim të Urdhërit të Prokurorit të Përgjithshëm nr.164, datë 18.12.2020 «Për miratimin e rregulloreve standard të organizimit dhe funksionimit të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm», janë marrë masa për shpërndarjen dhe njohjen e tij për prokurorët, oficerët dhe nëpunësit e tjetër të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë dhe marrjen e masave për zbatimin e këtyre ndryshimeve gjatë punës në Prokurori.

Në zbatim të vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 326, datë 02.06.2021, udhezimit të përgjithshëm nr. 4 datë 09.07.2021 « Për rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave për luftën kundër kriminalitetit në vitin 2021 në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm » dhe urdhërit nr. 79, datë 09.07.2021 « Për miratimin e planit të veprimit për zbatimin e Rekomandimeve Prioritare të Këshillit të Ministrave për luftën kundër kriminalitetit në vitin 2021 » , është bërë shpërndarja dhe njohja e këtij plani veprimi dhe zbatimin e tij nga të gjithë prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore të Prokurorisë pranë Gjykatës të Shkallës së Parë Lezhë. Në vijim në mbledhjet e zhvilluara, takimet dhe udhëzimet e dhëna janë diskutuar pikat e këtij plani veprimi, mënyra e zbatimit të tij dhe fazat e zbatimit. Gjithashtu, janë orientuar prokurorët dhe oficerët në zbatimin e drejtëpërdrejtë të tij gjatë ushtrimit të ndjekjes penale dhe kryerjes së veprimeve hetimore në çështje konkrete, detyrave administrative që janë objekt dhe fokus i VKM nr. 326, datë 02.06.2021 dhe urdhërit të Prokurorit të Përgjithshëm.

Masa konkrete janë marrë edhe në drejtim të nxitjes së prokurorëve dhe shpejtësisë dhe cilësisë së kryerjes së veprimeve hetimore dhe hetimeve në lidhje me të gjitha procedimet penale, por në veçanti me procedimet penale për çështjet e trajtuara në rekomandimet prioritare. Në fazën e hetimeve u është kërkuar prokurorëve dhe oficerëve të koordinojnë veprimet mes tyre dhe me institucionet e tjera ligjzbatuese në drejtim të kryerjes në kohë dhe me cilësi të veprimeve hetimore dhe në administrimin e akteve dhe provave për këto çështje. Në fazën e gjykimit janë orientuar dhe nxitur prokurorët në aplikimin e instituteve të reja dhe gjykimeve të posacme dhe në pasjen parasysh të masave të dënimit të përshtatshme në rastin e çështje objekt të Rekomandimeve.

Janë marrë masa dhe janë nxjerrë urdhëra dhe udhëzime edhe për oficerët e policisë gjyqësore në lidhje me rritjen e cilësisë dhe efektivitetit të veprimeve hetimore të kryera prej tyre, në lidhje me raportimet periodike për veprimet e kryera, si dhe për rritjen e cilësisë së relacioneve të cështjeve të përfunduara dhe shpejtësisë së përfundimit të tyre.

Në lidhje me qarkullimin e brendshëm të akteve është nxjerrë një urdhër nga ana e drejtuesit ku mbahet një regjistër i dorëzimit të materialeve tek secili prokuror dhe oficer i policisë gjyqësore.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë funksionon edhe në zbatim të Rregullores Standart për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë e cila është hartuar duke marrë në konsideratë edhe parashikimet e urdhërit nr. 120, datë 08.09.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm, zbatimi I së cilës ndiqet me shumë kujdes nga ana Drejtuesit të Prokurorisë

Pokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë fuknsionin pa seksione. Kjo pasi janë një numër i vogël prokurorësh dhe nëse do krijohen seksione është e veshtirë ndarja e çeshtjeve në mënyrë të barabartë. Për hetimin e çeshtjeve penale me të mitur është caktuar një prokuror.

Sqarojmë se në Prokurorinë Lezhë çështjet ndahen sipas shortit elektronik. Shortin elektronik e hedh sekretari i regjistrit nën mbikqyerjen e drejtuesit të prokurorisë. Në çështjet me të arrestuar për shkak të veprimeve të para hetimore dhe afateve prekluzive procedurale çeshtja i kalon prokurorit të gatshëm. Është mbajtur në funksion sistemi elektronik i ndarjes dhe menaxhimit të çështjeve në Prokurori (sistemi CAMS), duke bërë pasqyrimin e saktë në sistem të shortit dhe në vijim të fazave të tjera të procedimit penal. Së fundmi edhe çështjet që duhen rishortuar pas largimeve për arsye të ndryshme të cituara në këtë shkresë, të prokurorëve, është përdorur sistemi

CAMS në bashkëpunim me Prokurorinë e Përgjithshme. Gjithashtu, është kërkuar përgjegjshmëri në hedhjen dhe nxjerrjen e statistikave nga zyra e rregjistrit.

Nga Drejtuesi i Prokurorisë është proceduar herë pas here me dhënie udhëzimesh jo të detyrueshme për çështje të veçanta. Në pjesën më të madhe këto udhëzime janë zbatuar.

Gjatë vitit 2021 personeli administrativ i kësaj prokurorie i ka kryer me korrektesë detyrat përkatëse, duke qenë një mbështetje e rëndësishme për prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore në përballimin e ngarkesës në punë dhe krijimin e raporteve korrekte me qytetarët, të cilëve u ofrohen shërbime administrative nga ana e Prokurorisë.

Zyra e Regjistrit e përbërë nga 1 person i vetëm që mbulohet nga Kryesekretarja, e cila është e ngarkuar me administrimin e regjistrave fizik dhe elektronik, shotin manual dhe elektronik, sistemin CAMS. Gjithashtu është e angazhuar në procesin e vetingut/ kërkesave për verifikim në zbatim të V.K.M-së 188 datë 04.03.2015 për pasjisjen më çertifikata sigurie, verifikimin për kërkesat për ekstradim, e të tjera që kanë të bëjnë me detyrën funksionale të kryesekretares, në zbatim të Rregullores Standart për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë.

Zyra e Protokolli në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë mbahet nga një sekretare e cila ka ushtruar funksionin e saj sipas ligjit nr. 9154 datë 06.11.2003 “Për arkivat”dhe “Normat tekniko – profesionale dhe metodologjike të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të Rregullores Standart për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë, ku janë regjistruar mbi 11.313 praktika/lëndë, pa fraksione, të cilat kanë më shumë se një nënlëndë. Sekretarja për protokollin mban dhe regjistrin e provave materiale ku numri i tyre vetëm për viti 2021 është rreth 30 prova.

Arkivi i institucionit mbahet nga sekretari për arkivin, i cili ka ushtruar funksionin e tij sipas ligjit nr. 9154 datë 06.11.2003 “Për arkivat”dhe “Normat tekniko – profesionale dhe metodologjike të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të Rregullores Standart për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë, ku merret me administrimin arkivit, merr në dorëzim dhe inventarizon të gjitha praktikat e mbyllura të vitit paraardhës. Këtë vit janë arkivuar 12548 praktika sipas protokollit të vitit 2020, të dorëzuara nga zyra e protokolli, dhe 1170 cështje/procedime penale të përfunduara (mosfilluar, pushuar, fashikujt e gjykimit).

Specialisti i Teknologjisë së Informacionit, i cili mbulon si IT edhe Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Kurbin, përveç punës sipas Rregullores Standart për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë, kryen dhe detyrën e Kordinatorit për të Drejën e Informimit.

Koordinatori për asistencën e viktimave të krimit asiston rastet me të miturve në konflikt me ligjin, të mitur viktima dhe dëshmitarë, si dhe rastet e dhunës me bazëgjinore duke bërë gjithshtu koordinimin me sistemet referuese. Mban gjithashtu edhe regjistrin e referimeve penale me të mitur.

Gjatë vitit 2021, buxheti financiar i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor është administruar me rigorozitet dhe si pasojë e disiplinës financiare dhe ndihmës gjithëvjetore nga Prokuroria e Përgjithshme për zera të veçantë të tij, nga ana e kësaj Prokurorie janë likujduar pothuajse të gjitha detyrimet ndaj subjekteve të tjerë, ato për shpenzimet proçedurale, të pagesës së mbikohës së punës etj.
Në cilësinë e Drejtuesit të Prokurorisë vlerësoj se marrëdhëniet me median dhe publikun kanë qenë korrekte. Nga ana e Prokurorisë është shprehur gatishmëria për të dhënë informacion subjekteve të interesuar në çdo rast që është gjykuar se nuk cënohen hetimi dhe veprimet procedurale përkatëse. Në respektim edhe të normave Kushtetuese është respektuar e drejta për informim e subjekteve të ndryshme. Në rast të refuzimit të kërkesave për informacione lidhur me çështje konkrete, ato janë argumentuar bazuar në normat procedurale penale mbi ruajtjen e sekretit hetimor.

Lidhur me administrimin e dokumentacionit të Prokurorisë, konstatoj se jo vetëm regjistrat, por i gjithë dokumentacioni që administrohet në Prokurori mbahet dhe ruhet rregullisht. Lidhur me mbajtjen e regjistrave, në Prokurori ushtron veprimtarinë punonjësi i ngarkuar posaçërisht me detyrën e mbajtjes së tyre dhe deri më tani nuk konstatohen problematika.

Përgjatë vitit 2021, vlerësoj se kapacitetet infrastrukturore kanë qenë të mjaftueshme me qëllim realizimin e aktivitetit të Prokurorisë. Megjithatë, kjo çështje meriton një vëmëndje të veçantë në varësi edhe të organikës së Prokurorisë apo nevojave për të kryer detyra të caktuara.

Sa i përket sigurisë, kjo është realizuar nëpërmjet shërbimeve private të ruajtjes fizike deri në maj të vitit 2021, caktuar nëpërmjet procedurë së prokurimit në përputhje me ligjin për prokurimin publik sic ka qënë në vitet e mëparshme. Nga data 10 maj 2021 e në vazhdim është lidhur kontrata me shoqërinë "**Illyrian Guard"sh.a Tiranë**.
Nuk rezulton të ketë pasur problemtika lidhur me sigurinë, megjithatë, ashtu siç jemi shprehur edhe në raporte të viteve paraardhëse në godinën e Prokurorisë Lezhë mungojnë kamerat e sigurisë pasi ata janë të dëmtuara dhe ka vite që nuk funksionojnë. Për këtë fakt është vënë në dijeni edhe Prokurori i Përgjithshëm me shkresë. Gjithashtu mungon sistemi i sigurisë së prokurorisë për të regjistruar hyrjet dhe daljet në godinë.

Përgjatë vitit 2021 vlerësoj se përgjithësisht është respektuar disiplina në punë dhe etika nga prokurorët, oficerët dhe punonjësit e administratës.

Aktualisht në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë, statistikat mbahen nga Kryesekretarja e cila ushtron edhe një sërë detyrash të tjera.

Megjithatë, ashtu si krimi nuk përfundon kurrë rrugën e vet, ashtu edhe puna e prokurorisë dhe policisë gjyqësore, nuk mund të përfundojë, por duhet të ecë me hapa më të shpejtë se sa krimi, me qëllim, bërjen të mundur zbardhjen e çështjeve dhe vënien para përgjegjësisë të autorëve të veprave penale.

# VIII-DREJTIMET DHE PËRPARËSITË NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT PËR VITIN 2021 DHE REKOMANDIME

Nga analiza në tërësi e elementëve qe u përmendën më lart, paraqesim përfundimet dhe rekomandimet që mendojmë se i do i shërbejnë punës së mëtejshme të Prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë:
Përfundimi më i rëndësishëm i analizës së mësipërme është konstatimi i faktit të rritjes së vazhdueshme të ngarkesës efektive të Prokurorëve të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë përgjatë vitit 2021. Duke marrë në konsideratë kontekstin aktual ligjor, si edhe ngarkesën e punës së prokurorëve dhe oficerëve, ashtu siç është propozuar edhe në vitet paraardhëse, do të vlerësoja se një numër më i lartë prokurorësh dhe oficerësh të policisë gjyqësore, do të bënte të mundur vijueshmërinë normale të punës në Prokurori. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë ka në organikën e saj 8 prokuror, një Drejtues Prokurorie dhe një Zëvendësdrejtues që shkojnë gjithësej 10 prokuror.

Një nga problematikat kryesore të konstatuara gjatë vitit 2021, ka qenë mungesa e prokurorëve në organikën dhe strukturën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë, ku ka pasur një mungesë që ka ardhur në rritje, 2 prokurorë janë shkarkuar, 1 prokuror është pezulluar, 2 prokurorë janë transferuar dhe aktualisht 1 prokuror është me raport mjekësor pa afat, momentalisht Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë ka 3 prokuror dhe drejtuesin (i cili ka ngarkesë të limituar) fakt që ka ndikuar në ngarkesën në prokurori, në ngarkesën e çdo prokurori me dosje në hetim dhe gjykim, si dhe në pamundësinë e pasjes së seksioneve. Kjo ka ndikuar edhe në cilësinë e hetimeve, shpejtësinë dhe plotësinë e hetimeve dhe mundësinë e rritjes së efektivitetit dhe evadimit të dosjeve të mbartura në vitet e mëparshme, etj.

Nga ana tjetër kjo do të ndihmonte në realizimin e objektivave të mëposhtme

- Përfundimi në një afat sa më të shkurtër i proçedimeve penale të mbartura nga viti 2021 dhe vitet e kaluara.
- Vazhdimi i ndjekjes me përparësi të proçedimeve penale në fushën e krimit ekonomik dhe abuzimit me detyrën nga nëpunësit shtetërore, ne fushën e veprave penale kundër jetës së personit dhe moralit, pasurisë, rendit dhe sigurisë etj.
- Intensifikimi i përpjekjeve nga prokurorët për të berë të mundur rritjen e treguesve të zbulueshmerise së veprave penale me rrezikshmëri të lartë shoqërore dhe marrjen në përgjegjësi penale të subjekteve përkatëse, si pastrimin e produkteve të veprës penale, vjedhjet etj, të cilat janë më të ndjeshme për shoqerinë tonë.
- Rritja e funksionit drejtues dhe kontrollues të prokurorit ndaj policisë gjyqësore, në seksionin dhe shërbimet e policise gjyqesore.
- Përmirësimi i organizimit, drejtimit dhe kontrollit të punës brenda organit, me qëllim për t'iu përgjigjur më mirë kërkesave për rritjen e cilësisë së punës.

- Respektimi nga prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore i detyrimeve të ligjit proçedural penal, urdhërave dhe udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm dhe atyre të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.
- Rritja e profesionalizimit të prokurorëve në hetimin paraprak, në marrjen e vendimeve përfundimtare, në paraqitjen e kërkesave para gjyqtarit të seancës paraprake dhe në mbrojtjen e akuzës në gjykim si dhe ruajtjen e etikës dhe disiplinës në punë.

Në organikën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë janë gjithsej 11 përsona në administratë, nga të cilët 1 Kryesekretare e cila mban dhe Zyrën e Regjistrit, 2 sekretar pranë prokurorëve, 1 sekretare pranë Drejtuesit të Prokurorisë, 1 sekretar arkivist, 1 punonjës IT-e, 1 kordinator për të drejtën e viktimës, 1 financiere, 1 ftues,1 shofer dhe 1 sanitare. Gjatë vitit 2021 administrata e prokurorisë ka kryer me korrektesë detyrat e veta, duke qenë një mbështetje e rëndësishme për prokurorët dhe oficeret e policisë gjyqësore në përballimin e kësaj ngarkese pune dhe krijimin e raporteve korrekte me qytetarët, të cilëve u ofrohen shërbime administrative nga ana jonë.

Përsa i përket shortit manual të kallëzimeve penale, për të qenë sa më transparent ky short është zhvilluar në zyrën e drejtuesit dhe në mungesë në atë të zëvendësdrejtuesit, duke informuar dhe siguruar pjesëmarrjen e të gjithë prokurorëve në orën e zhvillimit të shortit. Materialet kallëzuese shortohen me anë të numrit të kallëzimit të marrë nga zyra e regjistrit dhe të gjithë pjesëmarrësit në short nuk kanë asnjë informacion në lidhje me përmbajtjen, veprën penale të materialeve që shortohen.

Një sistem shortimi elektronik, i cili bën një shpërndarje të barabartë të cështjeve penale, është tashmë një domosdoshmëri, pavarësisht se me ndryshimet e reja që i janë bërë këtij sistemi është vënë re një përmirësim i shpërndarjes së çështjeve.

Buxheti financiar i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë është administruar me rigorozitet dhe si pasojë e disiplinës financiare dhe ndihmës nga Prokuroria e Përgjithshme për zëra të vecantë të tij, nga ana e kësaj Prokurorie janë likuiduar pjesa më e madhe e detyrimeve ndaj subjekteve të tjerë, ato për shpenzimet procedurale, të pagesës së mbikohës së punës etj.
Nisur nga të dhënat e 12 - mujorit të vitit 2021, mbi përdorimin e fondeve buxhetore rezulton sa më poshtë vijon:

